

**RAPORT NGA HULUMTIMI I PERCEPTIMIT
TË FORMAVE GJINORE TË KORRUPSIONIT
NË MAQEDONINË E VERIUT
- SEKTORËT ARSIM I LARTË DHE
ADMINISTRATË PUBLIKE**

Sextortion

PËRMBAJTJA

TITULL: RAPORT NGA HULUMTIMI I PERCEPTIMIT TË FORMAVE GJINORE TË KORRUPSIONIT NË MAQEDONINË E VERIUT - SEKTORËT ARSIM I LARTË DHE ADMINISTRATË PUBLIKE

Autore: TIM Instituti

Perktheu dhe lekturoi: Fatos Kica
Luljeta Adili-Celiku

ISBN: 978-92-9271-070-5

osbe Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Shkup

www.osce.org/skopje
© OSCE Mission to Skopje 2022

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të shfrytëzohet dhe shumëzohet për qëllime arsimore dhe qëllime tjera jokomerciale, me kusht që gjatë çdo riprodhimi të tillë si burim të ceket Misioni i OSBE-së në Shkup.

Materialet në këtë botim janë vetëm për referim. Edhe pse Misioni i OSBE-së në Shkup ka përkushtuar kujdesin më të madh në zhvillimin e tij, i njëjti nuk pranon asnjë përgjegjësi për saktësinë dhe plotësinë e informacioneve, udhëzimeve dhe këshillave të ofruara, apo për ndonjë gabim shtypi. Përmbajtja e këtij botimi, pikëpamjet, mendimet, gjetjet, interpretimet dhe konkluzionet e shprehura këtu nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare ose qëndrimin e OSBE-së. Për këto arsye, asnjë pretendim nuk mund të bëhet kundër OSBE-së lidhur me pasojat e mundshme nga besueshmëria e informacioneve ose konkluzioneve të përfshira në këtë botim.

RAPORT NGA HULUMTIMI I PERCEPTIMIT TË FORMAVE GJINORE TË KORRUPSIONIT NË ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

REZYME	6
RAPORTI METODOLOGJIK	8
STRUKTURA DEMOGRAFIKE E TË ANKETUARVE	11
1. Ndikimi i korrupsionit	12
2. Korrupsioni si problem	14
3. Nxitja e korrupsionit dhe nënshtrimi ndaj tij	16
4. Përvoja korrupsioni	18
5. Zhvatja për shërbime seksuale	19
6. Prania e shërbimeve seksuale	21
7. Përvojat personale	24
8. Raportimi i mbrojtur	34
9. Njohuritë për format e veçanta të korrupsionit	38
10. Çrënjosja e korrupsionit	42
GJETJET KRYESORE	44

RAPORT NGA HULUMTIMI I PERCEPTIMIT TË FORMAVE GJINORE TË KORRUPSIONIT NË ADMINISTRATËN PUBLIKE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

REZYME	52
RAPORTI METODOLOGJIK	54
STRUKTURA DEMOGRAFIKE E TË ANKETUARVE	57
1. Korrupsioni si problem	58
2. Nxitja e korrupsionit dhe nënshtrimi ndaj tij	61
3. Zhvatja e shërbimeve seksuale nga punonjës të administratës shtetërore ndaj qytetarëve si përdorues të shërbimeve	66
4. Njohuritë për format specifike të korrupsionit	68
5. Prania e zhvatjes seksuale në institucione	72
6. Zhvatja e shërbimeve seksuale brenda vetë institucioneve publike (punonjës nga pozita autoriteti dhe pushteti, ndaj punonjësve tjerë)	76
7. Përvojat personale	80
8. Denoncimi i mbrojtur	89
9. Çrënjosja e korrupsionit	93
GJETJET KRYESORE	97

**RAPORT NGA HULUMTIMI I
PERCEPTIMIT TË FORMAVE
GJINORE TË KORRUPSIONIT
NË ARSIMIN E LARTË
NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT**

-studentë-

gusht, 2022

Shkup

REZYME

Barazia gjinore nënkupton që femrat dhe meshkujt kanë të drejta dhe mundësi të barabarta për të realizuar potencialin e tyre individual, duke kontribuar kështu në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit të tyre, por me përfitim të caktuar nga pjesëmarrja e tyre në shoqëri.

Korrupsioni paraqet rrezik për të drejtat e njeriut dhe kontribuon në rritjen e diskriminimit social, kulturor, politik dhe institucional, dhe në të njëjtën kohë parandalon arritjen e barazisë gjinore, përkeqëson atë dhe thekson pabarazinë sociale për qasje në shërbimet publike.

Hulumtimet bashkëkohore përpiqen të shpjegojë dallimet midis femrave dhe meshkujve në kuptimin dhe përjetimin e korrupsionit, gjininë e atyre që janë përfshirë në akte korrupsioni, dallimet në “llojin e valutës” së përdorur nga femrat dhe meshkujt për të paguar për aktet e korrupsionit, si dhe ndikimin e ndryshëm të korrupsionit në përditshmërinë e meshkujve dhe femrave.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut mungojnë të dhënat empirike lidhur me format gjinore të korrupsionit, ndikimin e formave gjinore të korrupsionit, rezistencën ndaj këtyre formave, etj. Pas kryerjes së një sondazhi mbarëkombëtar në vitin 2021 ku për ekzemplar hulumtimi u morën femrat në Maqedoninë e Veriut, për të parë perceptimin e tyre në lidhje me format e korrupsionit me bazë gjinore, veçanërisht zhvatjen seksuale – si më të cenuar nga kjo formë korrupsioni u detektuan dy sektorë shoqërorë, e që janë: arsimi i lartë dhe administrata shtetërore.

Mungesa e të dhënave empirike lidhur me format gjinore të korrupsionit, veçanërisht për situatën në arsimin e lartë, ishte një nxitje shtesë për realizimin e këtij hulumtimi.

Për të siguruar të dhënat përkatëse, u krye një anketë në një mostër të një grupi të synuar që është ende në proces arsimor në arsimin e lartë, studentë nga viti i parë deri në të vitin e gjashtë të studimeve, si dhe studentë që janë në studime pasuniversitare në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Gjetjet e këtij hulumtimi mund të përdoren për diskutime të mëtejshme me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit të politikëbërësve për nevojën e institucionalizimit dhe kriminalizimit të formave gjinore të korrupsionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

RAPORTI METODOLOGJIK

Për nevojat e hulumtimit u përdor një mostër i një pjese të popullatës që ende është në proces arsimor në arsimin e lartë, studentë nga viti i parë deri në vitin e gjashtë të fakultetit, si dhe studentë që janë në studime pasuniversitare në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Hulumtimi është realizuar me gjithsej 800 të anketuar (nga gjithsej 51582 studentë në RMV), studentë nga të gjitha institucionet e arsimit të lartë të akredituar në Republikën e Maqedonisë së Veriut (publike dhe private).

Për qëllimet e hulumtimit është përdorur modeli i intervistës telefonike CATI.

Lloji i mostrës

Në fazën e modelimit të mostrës për sektorin e arsimit të lartë, Instituti mori parasysh: gjininë, përkatësinë etnike, vitin e studimit dhe universitetet në nivel vendi.

Numri i synuar i intervistave u shpërnda proporcionalisht sipas numrit total të studentëve në vend, në bazë të të dhënave më të fundit të cilat janë në dispozicion nga regjistrimi i vitit 2021.

Sipas të dhënave të Entit Shtetëror për Statistikë, në vitin akademik 2021/2022 në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë regjistruar gjithsej 51582 studentë.

Numri i studenteve të regjistruara është 29858 ose 58%. Numri më i madh i studentëve (83%) janë regjistruar në institucionet e arsimit të lartë shtetëror, ndërsa 16.8% janë regjistruar në institucionet e arsimit të lartë privat.¹

¹ <https://www.stat.gov.mk/PrikaziSooopstenie.aspx?rbtxt=29>

Përzgjedhja e të anketuarve

Çdo intervistues duhet të ketë të paktën tre përpjekje për të realizuar kontaktin telefonik me amvisërinë e përzgjedhur. Nëse edhe pas tre përpjekjeve gjatë punës nuk vendoset kontakti me familjen, kontaktohet një amvisëri tjetër sipas procedurës së paracaktuar për përzgjedhje të amvisërisë.

Anketuesit regjistrojnë rezultatet e të gjitha përpjekjeve për të vendosur kontakt në të ashtuquajturat Lista të Kontakteve.

Në një amvisëri mund të anketohet vetëm një person i përzgjedhur.

Sistemi për kontrollin e cilësisë

Rreth 25% e intervistave të kryera i nënshtrohen kontrollit.

Rrjeti i anketimit dhe mbikëqyrjes

Hulumtimi u realizua nga një rrjet i zhvilluar intervistuesish me përvojë (operatorë telefonikë), në gjuhën maqedonase dhe shqipe.

Në këtë projekt ishin të angazhuar 29 intervistues me përvojë.

Kohëzgjatja e hulumtimit

Para fillimit të anketës telefonike, të gjithë intervistuesit ndoqën një trajnim teorik mbi metodologjinë dhe procedurën e punës, i cili përfshinte një shpjegim lidhur me kuptimin dhe zbatimin e procedurave të mëposhtme:

- ◆ Përzgjedhjen e amvisërisë;
- ◆ Përzgjedhjen e të anketuarit;
- ◆ Shpjegimin e metodës së plotësimit të pyetësorit programatik


Hulumtimi u realizua nga data 23.06.2022 deri më 04.07.2022.

Për përpunimin dhe analizimin e të dhënave të siguruar është përdorur softueri profesional për përpunimin e të dhënave statistikore SPSS për Windows.


Për përgatitjen e raportit, grafikëve dhe tabelave u përdorën SPSS për Windows dhe Microsoft Office për Windows (Word dhe Excel).

STRUKTURA DEMOGRAFIKE E TË ANKETUARVE


GJINIA




UITI I STUDIMEVE



PËRKATËSIA ETNIKE



VENDBANIMI




1. Ndikimi i korrupsionit

Shtatë nga dhjetë të anketuar besojnë se korrupsioni prek njësoj si femrat ashtu edhe meshkujt.

Nga grafiku i mëposhtëm, shihet se 14% vlerësojnë se korrupsioni ka një ndikim më të madh te femrat, ndërsa 10% theksojnë se ka një ndikim më të madh te meshkujt.

Grafiku 1 Sipas mendimit tuaj, a ka korrupsioni efekt të njëjtë negativ te femrat dhe te meshkujt?



Përkundër faktit se numri më i madh i të anketuarve besojnë se korrupsioni prek njësoj si meshkujt ashtu edhe femrat, duke marrë parasysh përgjigjet përmes prizmit të karakteristikave demografike, vërehet se femrat me 6% më shumë besojnë se korrupsioni ndikon më shumë te femrat, por meshkujt dyfish më shumë janë përgjigjur se korrupsioni ndikon më shumë te meshkujt. Gjithashtu, studentët që i përkasin bashkësisë etnike shqiptare besojnë se korrupsioni më shumë prek femrat (maqedonasit 11%, shqiptarët 25%).

		GJINIA		Gjithsej
		Meshkuj	Femra	
Sipas mendimit tuaj, a ka korrupsioni efekt të njëjtë negativ te femrat dhe te meshkujt?	Korrupsioni më shumë ndikon te femrat	10,8 %	16,3 %	14,1 %
	Korrupsioni më shumë ndikon te meshkujt	13,9 %	7,7 %	10,2 %
	Njësoj edhe te meshkujt, edhe te femrat	71,2 %	73,3 %	72,4 %
	Pa përgjigje	4,0 %	2,7 %	3,2 %
		100,0 %	100,0 %	100,0 %

		Përkatësia etnike			Gjithsej
		Maqedonas	Shqiptarë	Bashkësi më të vogla etnike	
Sipas mendimit tuaj, a ka korrupsioni efekt të njëjtë negativ te femrat dhe te meshkujt?	Korrupsioni më shumë ndikon te femrat	11,1 %	24,5 %		14,1 %
	Korrupsioni më shumë ndikon te meshkujt	8,7 %	14,5 %	11,5 %	10,2 %
	Njësoj edhe te meshkujt, edhe te femrat	77,1 %	57,0 %	88,5 %	72,4 %
	Pa përgjigje	3,1 %	4,0 %		3,2 %
		100,0 %	100,0 %	100,0 %	100,0 %

2. Korrupsioni si problem

Korrupsioni në kuptimin më të gjerë përkufizohet si shpërdorim i detyrës zyrtare me qëllim të përfitimit personal ose për një person tjetër. Korrupsion nënkupton gjithashtu çdo formë abuzimi me pozitën ose autoritetin, me qëllim që të realizohet përfitim personal ose për një person tjetër, qoftë në sektorin publik apo atë privat.

Duke pasur parasysh ndjeshmërinë e fenomenit dhe veçanërisht lidhjen e tij me monitorimin e rasteve të korrupsionit dhe përcaktimin e mundësive për një luftë efektive kundër korrupsionit, ajo duhet të realizohet dhe zbatohet në një mënyrë apolitike, neutrale, të pavarur, të drejtë, transparente dhe mbi të gjitha, në mënyrë ligjore.


Pyetja e radhës ka të bëjë me perceptimin e të anketuarve për shtrirjen e korrupsionit në arsimin e lartë. Grafiku tregon shkallën në të cilën ata e trajtojnë korrupsionin si problem.

Vihet re se pothuajse dy të tretat, pra 65%, kanë theksuar se korrupsioni është një problem i madh, 19% se është një problem i vogël, ndërsa për 3% të/ të anketuarve, korrupsioni nuk përbën aspak problem në arsimin e lartë.

Nga kjo mund të konstatohet se shumica e të anketuarve (84%) pajtohen se korrupsioni në arsimin e lartë paraqet një **problem** në vendin tonë, ndërsa gjashtë nga dhjetë të anketuar e konsiderojnë atë si një problem të **madh**.

Të anketuarit që janë përgjigjur se korrupsioni është problem në arsimin e lartë, gjithashtu u është kërkuar që ta vlerësojnë intensitetin e problemit në një shkallë nga 1 deri në 9, ku 1 shënon intensitetin më të ulët dhe 9 intensitetin më të lartë. Nota mesatare e përgjigjeve të tyre është **6.87**, që paraqet një intensitet të lartë të pranisë së problemit.

Grafiku 2 Sipas mendimit tuaj, a është korrupsioni në arsimin e lartë një problem i madh, një problem i vogël apo nuk është aspak problem?



Studentët që i përkasin bashkësisë etnike shqiptare në një masë më të vogël theksojnë se në përgjithësi, korrupsioni paraqet një problem të madh në arsimin e lartë? (maqedonasit 69%, shqiptarët 51%).


		Përkatësia etnike			Gjithsej
		Maqedonas	Shqiptarë	Bashkësi më të vogla etnike	
Sipas mendimit tuaj, a është korrupsioni në arsimin e lartë një problem i madh, një problem i vogël apo nuk është aspak problem?	Problem i madh	68,9 %	51,5 %	76,9 %	64,8 %
	Problem i vogël	21,7 %	13,5 %	3,8 %	19,1 %
	Aspak nuk paraqet problem	3,1 %	4,5 %		3,4 %
	Refuzon të përgjigjet	1,7 %	18,0 %	7,7 %	6,0 %
	Pa përgjigje	4,5 %	12,5 %	11,5 %	6,7 %
		100,0 %	100,0 %	100,0 %	100,0 %

3. Nxitja e korrupsionit dhe nënshtrimi ndaj tij

Grupi tjetër i pyetjeve ka të bëjë me inkurajimin dhe nënshtrimin ndaj korrupsionit në arsimin e lartë. Për sa i përket nxitjes, të anketuarit vlerësojnë burimet e ndryshme të korrupsionit në një shkallë nga 1 në 9, ku 1 është më pak nxitës dhe 9 më nxitës.


Sipas të anketuarve, si **nxitës kryesor i korrupsionit në arsimin e lartë veçohet kuadri mësimdhënës dhe shkencor** (profesorë, docentë, asistentë), të cilët janë vlerësuar me notën mesatare 6,4. Menjëherë pas tyre janë ndërmjetësuesit (me një notë mesatare 5,8), të ndjekur nga stafi drejtues, dekanët dhe prodekanët (me notë mesatare 5). Shërbimet studentore (dhe pjesa tjetër e administratës), si dhe familja e studentit vlerësohen në mënyrë të barabartë me një notë mesatare prej 4,5. Të anketuarit vlerësojnë veten si nxitësit më të rrallë të korrupsionit në arsimin e lartë (me një vlerësim mesatar prej 4,4).

Grafiku 3 Sipas mendimit tuaj, në çfarë mase mendoni se secila nga kategoritë e cekura më poshtë inkurajon korrupsionin në arsimin e lartë? Në një shkallë nga 1 deri në 9, ku 1 është më pak inkurajues dhe 9 më shumë inkurajues?



Nënshtrimi ndaj korrupsionit, parë nga prizmi i përgjigjeve të të anketuarve, tregon se ai ka përfaqësim gjinor. Më shumë se dy të tretat (77%) theksuan se **nuk i dallojnë kontekstet gjinore të korrupsionit**, gjegjësisht si meshkujt ashtu edhe femrat njëlloj i nënshtrohen korrupsionit. Rreth 10% e të anketuarve besojnë se femrat më pak i nënshtrohen korrupsionit se sa meshkujt, por pothuajse po aq të anketuar (10%) besojnë të kundërtën, se femrat i nënshtrohen korrupsionit më shumë se sa meshkujt. Në aspekt statistikor, nuk vërehen dallime të rëndësishme në përgjigjet e të anketuarve, parë nga prizmi i karakteristikave të tyre demografike.


Grafiku 4 Sipas mendimit tuaj, a i nënshtrohen femrat korrupsionit po aq sa burrat (kush është më i korruptuar)?



4. Përvoja korrupsioni

Për sa i përket përvojës personale me korrupsionin në arsimin e lartë, rreth 13% e të anketuarve kanë deklaruar se u ka ndodhur që profesori/profesoresha të mos kërkojë drejtpërdrejt, por t'u përcillte përmes një ndërmjetësi se pret para, dhuratë apo shërbim. Rreth një në dhjetë të anketuar me vetëiniciativë i kanë dhënë para, dhuratë ose shërbim një profesori/profesoresha. 6% të të anketuarve u ka kërkuar para, dhuratë ose favor një person nga shërbimet administrative/studentore dhe e njëjta përqindje është tek ata që kanë deklaruar se një profesor i ka kërkuar drejtpërdrejt para, dhuratë apo shërbim. Vetëm 3% të të anketuarve u ka ndodhur që një dekan/prodekan ose person tjetër drejtues t'u ketë kërkuar para, dhuratë apo shërbim, që tregon se ata janë burimi më i rrallë i korrupsionit në arsimin e lartë.

Grafiku 5 A ju ka ndodhur gjatë studimeve diçka nga këto më poshtë?




5. Zhvatja për shërbime seksuale

Format e korrupsionit mund të jenë të ndryshme. Korrupsioni nënkupton shfrytëzimin e detyrës dhe pozitës për qëllime të paligjshme ose joetike me qëllim të realizimit të një përfitimi. Zhvatja për shërbime seksuale nga punonjësit e arsimit të lartë në këmbim të ofrimit të një shërbimi **njihet si formë korrupsioni nga 89% e të anketuarve.**


Vetëm 7% e të anketuarve mendojnë se zhvatja për shërbime seksuale nga punonjësit e arsimit të lartë në këmbim të ofrimit të një shërbimi nuk paraqet një formë korrupsioni, ndërsa 4% shprehin pamundësinë për të dalluar korrupsionin në zhvatjen për shërbime seksuale.

Grafiku 6 A mendoni se zhvatja për shërbime seksuale nga punonjësit e arsimit të lartë me qëllim të ofrimit të një shërbimi paraqet një formë korrupsioni?



Nga të anketuarit që pajtohen se zhatja seksuale është një formë korrupsioni në arsimin e lartë, rreth **16% besojnë se kjo ndodh shumë shpesh** në vendin tonë. Më shumë se një e treta e të anketuarve (39%) deklarojnë se kjo ndodh **ndonjëherë**, ndërsa 23% konsiderojnë se kjo është një dukuri **rrallë** në arsimin e lartë. Vetëm 2.5% e të anketuarve pohojnë se zhatja për shërbime seksuale nga persona në pozitë të rëndësishme në institucionet e arsimit të lartë nuk ndodh **kurrë**.

Grafiku 7 Sa shpesh mendoni se zhatja seksuale ndodh si një formë korrupsioni në arsimin e lartë (baza: 714 të anketuar)?




6. Prania e shërbimeve seksuale

Në grafikun e mëposhtëm paraqiten situatat më të zakonshme në të cilat personat në pozitë të rëndësishme në arsimin e lartë (profesor, shef katedre, dekan...) kërkojnë shërbime seksuale në këmbim të dhënies së një favoriti.

Në pyetjen që ofron mundësinë e përgjigjeve të shumëfishta, numri më i madh i të anketuarve (77%) besojnë se kjo më shpesh ndodh me qëllim që studenti/studentja të kalojnë një provim, 41% thonë se zhatja seksuale ndodh për të marrë një notë më të lartë, ndërsa 38% kanë deklaruar se ndodh për qëllime punësimi në fakultet pas përfundimit të studimeve, ku një person mund të veprojë në mënyrë të palejueshme, sidomos kur ushtrohen të drejtat diskrecionale të anëtarëve të komisionit për të zgjedhur një kandidat sipas motiveve dhe përshtypjeve personale, që janë kryesisht të parëndësishme për vetë procedurën ose punën që duhet të bëjë kandidati.

Sipas të anketuarve, zhatja seksuale mund të përdoret për të shmangur një ndëshkim apo problem për studentin/studenten (21%) ose për të përshpejtuar ndonjë punë/procedurë që i nevojitet studentit/studentes (21%). Situata më e rrallë e përmendur në të cilën personat në pozitë të rëndësishme në arsimin e lartë kërkojnë shërbime seksuale është gjatë regjistrimit në fakultet (11%).

Grafiku 8 Në cilat situata do të thoni se personat që janë në pozita të rëndësishme në arsimin e lartë (profesor, shef katedre, dekan...) kërkojnë më shpesh shërbime seksuale?



Duke i shqyrtuar përgjigjet e të anketuarve përmes prizmit të gjinisë, vihet re se meshkujt më shpesh theksojnë se personat që janë në pozita të rëndësishme në arsimin e lartë zakonisht kërkojnë shërbime seksuale për të përshpejtuar një punë dhe për të shmangur një ndëshkim të mundshëm, ndërsa femrat më shpesh besojnë se kjo ndodh me qëllim të marrjes së një note më të lartë.

Në cilat situata do të thoni se personat që janë në pozita të rëndësishme në arsimin e lartë (profesor, shef katedre, dekan...) kërkojnë më shpesh shërbime seksuale?	GJINIA	
	Meshkuj	Femra
Për t'u përshpejtuar një punë/procedurë që i nevojitet studentit/studentes	23,5 %	19,4 %
Për t'i ikur një ndëshkimi/problem të studentit/studentes	26,0 %	18,2 %
Për t'u punësuar (në kuadër të fakultetit pas përfundimit të studimeve)	38,1 %	37,8 %
Për të kaluar një provim	77,7 %	76,8 %
Për një notë më të lartë	39,6 %	43,0 %
Për t'u regjistruar në fakultet	12,7 %	10,4 %


7. Përvojat personale

Pyetja e radhës nxjerr në pah përvojën e të anketuarve lidhur me zhvatjen për shërbime seksuale nga një person në pozitë të rëndësishme në arsimin e lartë, pavarësisht nëse është personale apo të anketuarit njohin dikë që ka pasur një përvojë të tillë.

Vërehet se pothuajse dy të tretat (65%) e të anketuarve nuk tregojnë hap-tas se a bëhet fjalë për përvojë personale apo përvojë të një personi tjetër në lidhje me këtë formë korrupsioni, por gjithsesi duhet pasur parasysh se duke folur për përvojën që ka të bëjë me zhvatje për shërbime seksuale lë hapësirë për etiketime shoqërore dhe shqetësime të pakëndshme që ndikojnë në jetën e mëtejme të viktimës.

Rreth 22% e të anketuarve kanë theksuar se nuk kanë pasur përvojë personale, por njohin dikë që kanë hasur në një formë të këtillë korrupsioni dhe 2.6% e të anketuarve që personalisht kanë përjetuar dhe janë ballafaquar me pasojat e zhvatjes për shërbime seksuale. Nga këta 2.6% ose 21 të anketuar, shtatë janë meshkuj dhe 14 janë femra. Për nga përkatësia etnike, 10 nxënës janë maqedonas etnik dhe 11 janë pjesëtarë të bashkësisë etnike shqiptare.

Grafiku 9 A keni pasur ju personalisht ose një person që ju njihni përvojë me një të punësuar në pozicion të rëndësishëm në arsimin e lartë (profesor, shef katedre, dekan...) që kërkon shërbime seksuale si formë korrupsioni?




Gjithashtu, duke i parë përgjigjet e të anketuarve nga prizmi i përkatësisë së tyre etnike, vërehet se numri më i madh i nxënësve të bashkësisë etnike shqiptare refuzojnë t'i përgjigjen kësaj pyetjeje.

		GJINIA		Gjithsej	
		Meshkuj	Femra		
A keni pasur ju personalisht ose një person që ju njihni përvojë me një të punësuar në pozicion të rëndësishëm në arsimin e lartë (profesor, shef katedre, dekan...) që kërkon shërbime seksuale si formë korrupsioni?	Po, më ka ndodhur mua personalisht	Numri	2	3	5
		%	0,6 %	0,6 %	0,6 %
	Mua personalisht dhe një personi që njoh	Numri	5	11	16
		%	1,5 %	2,3 %	2,0 %
	Nuk kam përvojë personale, por njoh dikë	Numri	68	109	177
		%	21,1 %	22,8 %	22,1 %
	As përvojë personale, as njoh dikë	Numri	202	317	519
		%	62,5 %	66,2 %	64,7 %
	Refuzon të përgjigjet	Numri	46	39	85
		%	14,2 %	8,1 %	10,6 %
Gjithsej		Numri	323	479	802
		%	%	100,0 %	100,0 %

		Numri	Pëkatësia etnike			Gjithsej
			Maqedonë	Shqiptarë	Bashkësi më të vogla etnike	
A keni pasur ju personalisht ose një person që ju njihni përvojë me një të punësuar në pozicion të rëndësishëm në arsimin e lartë (profesor, shef katedre, dekan...)	Po, më ka ndodhur mua personalisht	Numri	4	1	0	5
		%	0,7 %	0,5 %	0,0 %	0,6 %
që kërkon shërbime seksuale si formë korrupsioni?	Mua personalisht dhe një personi që njoh	Numri	7	9	0	16
		%	1,2 %	4,5 %	0,0 %	2,0 %
Pa përgjigje	Nuk kam përvojë personale, por njoh dikë	Numri	138	35	4	177
		%	24,0 %	17,5 %	15,4 %	22,1 %
Gjithsej	As përvojë personale, as njoh dikë	Numri	415	83	21	519
		%	72,0 %	41,5 %	80,8 %	64,7 %
		Numri	12	72	1	85
		%	2,1 %	36,0 %	3,8 %	10,6 %
		Numri	576	200	26	802
		%	100,0 %	100,0 %	100,0 %	100,0 %


Grafiku i mëposhtëm paraqet përgjigjet e 21 të anketuarve (100%) të cilët kanë pasur përvojë personale me zhatje për shërbime seksuale. Prej tyre, 62% nuk kanë paraqitur zhatjen (13 të anketuar), ndërsa 33% (7 të anketuar) e kanë bërë këtë. Vetëm një i anketuar (5%) ka refuzuar t'i përgjigjet kësaj pyetjeje. Për krahasim, sondazhi për aspektet gjinore të korrupsionit i kryer vitin e kaluar me një egzemplar përfaqësues prej 1000 femrave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, jep një shpërndarje pothuajse identike të përgjigjeve. Konkretisht, 37% e grave që kanë pasur përvojë personale me zhatje për shërbime seksuale në cilëndo sferë të jetës shoqërore kanë denoncuar zhatjen, ndërsa 61% nuk kanë bërë këtë. 2% kanë refuzuar t'i përgjigjen pyetjes.

Grafiku 9_1 A keni denoncuar rastin kur një person me pozicion të rëndësishëm në arsimin e lartë (profesor, shef katedre, dekan...) ju ka kërkuar shërbime seksuale si formë korrupsioni? (baza: 21 të anketuar)




Nga gjithsej 24% ose 193 të anketuar që njohin dikë që është përballur me zhatje për shërbime seksuale, vetëm 13.5% e tyre (26 të anketuar) kanë dijeni se viktima ka denoncuar këtë veprë penale.

Grafiku 9_2 A ka denoncuar e njohura juaj një përvojë të zhatjes për shërbime seksuale në vend të parave/ryshfetit si një formë korrupsioni?



Prirja për të denoncuar zhvatjen për shërbime seksuale, gjë që vërehet nga përgjigjet e të anketuarve, shënoi rritje të dukshme kur ata u pyetën hipotetikisht a do ta kishin denoncuar rastin në qoftë se do t'u ndodhte diçka e ngjashme në të ardhmen. Kësaj pyetjeje iu përgjigjën vetëm të anketuarit të cilët më parë nuk kanë denoncuar ndonjë përvojë të mëparshme me zhvatje për shërbime seksuale. Nga gjithsej 696 të anketuar (87% të numrit të përgjithshëm të të anketuarve), 77% do ta merrnin guximin për ta denoncuar veprën penale, ndërsa 11% e të anketuarve nuk do ta bënin këtë publike. Rreth një e teta e të anketuarve shprehën pamundësinë e tyre për të imagjinuar një situatë të tillë hipotetike të zhvatjes për shërbime seksuale, të cilën më pastaj do ta denoncin.

Grafiku 10 A do ta denonconit rastin nëse do t'ju ndodhte juve personalisht diçka e ngjashme? (baza: 696 të anketuar)




Nga 537 të anketuarve që do të bënin denoncim nëse në të ardhmen do të ishin dëshmitarë të një zhvatjeje për shërbime seksuale, 22% do ta denoncin rastin në të njëjtin institucion ku do të kishte ndodhur (në fakultet), ndërsa shumica e të anketuarve (78%) do të denoncin rastin në një institucion tjetër përkatës të jashtëm.

Denoncimi apo raportimi i brendshëm i mbrojtur kryhet nga brenda, gjegjësisht në vetë institucionin ose subjektin juridik ku kryhet/do të kryhet ky veprim i paligjshëm.

Konform ligjit, udhëheqësi i institucionit përkatës në sektorin publik cakton një person të autorizuar për pranimin e raporteve të dorëzuara, me qëllim të raportimit të brendshëm të mbrojtur. Në institucionet ku nuk ka person të autorizuar, raportimi i brendshëm i mbrojtur i bëhet personit drejtues².

Personi i autorizuar e ka për detyrë ta informojë sinjalizuesin jo më vonë se 15 ditë nga dita e pranimin të raportimit. Në këtë mënyrë, ai/ajo është i/e detyruar të mbrojë të dhënat personale të sinjalizuesit, gjegjësisht të dhënat që mund të zbulojnë identitetin e sinjalizuesit që denoncon në mënyrë anonime ose konfidenciale, në përputhje me rregulloret për mbrojtjen e të dhënave personale³.

Grafiku 11 Nëse do të raportoni zhvatjen për shërbime seksuale, ku do ta bënit këtë?




Pothuajse gjysma e gjithsej 116 të anketuarve që do të raportonin zhvatjen seksuale në institucionin ku u ka ndodhur, do ta bënin këtë te dekani ose prodekani i fakultetit të tyre (49%). Nga të anketuarit tjerë, 20% do ta raportonin rastin në një shërbim të posaçëm në fakultet, 10% do ta bënin këtë te personi i caktuar për raportim të mbrojtur në fakultet, ndërsa pjesa

² Rregullorja për raportimin e mbrojtur të brendshëm në institucionet e sektorit publik, Gazeta Zyrtare nr. 46/2016

³ Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve, neni 4, Gazeta Zyrtare nr. 196/2015, 35/18

tjetër do ta kontaktonte rektoratin, shërbimin juridik dhe pronarin e fakultetit (nëse do të ndodhte brenda një fakulteti privat).

Grafiku 12 Te kush do të raportonit në institucionin ku do t’ju kishte ndodhur rasti?




		GJINIA		Gjithsej
		Meshkuj	Femra	
Kujt do t’ia raportonit në institucionin ku do t’ju kishte ndodhur rasti?	Njësisë për raportim të mbrojtur	15,9 %	5,6 %	9,5 %
	Rektoratit	9,1 %	6,9 %	7,8 %
	Dekanit, prodekanit	43,2 %	52,8 %	49,1 %
	Shërbimit juridik	2,3 %	6,9 %	5,2 %
	Administratës së fakultetit	22,7 %	18,1 %	19,8 %
	Pronarit	2,3 %		0,9 %
	Nuk e di	4,5 %	9,7 %	7,8 %
		100,0 %	100,0 %	100,0 %

Raportimi i mbrojtur i jashtëm është një lloj denoncimi që kryhet jashtë institucionit, gjegjësisht jashtë personit juridik ku kryhet/do të kryhet ky veprim i paligjshëm. Institucionet kompetente për raportim të jashtëm janë: Ministria e Punëve të Brendshme; Prokuroria Publike, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK), Avokati i Popullit dhe institucionet tjera kompetente.

Sa i përket të anketuarve që preferojnë të denoncojnë zhatyje seksuale jashtë fakultetit, institucioni që përmendet më së shumti është policia. Nga gjithsej 421 të anketuar, rreth dy të tretat kanë veçuar policinë si institucionin ku do ta raportonin rastin (66%), 14% do t’i drejtoheshin KSHPK, 8% do të raportonin te Avokati i Popullit dhe 6% e të anketuarve deklaruan se do ta kishin denoncuar rastin “gjithkund”.


Pjesa tjetër e të anketuarve do t’ia kishin raportuar zhatyjen seksuale organizatave të shoqërisë civile, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, prindërve të tyre dhe mediave.

Grafiku 13 Në cilin institucion tjetër të përshtatshëm të jashtëm do të raportonit zhatyjen seksuale?



Përgjigjet e të anketuarve se nuk do të denonconin zhvatjen për shërbime seksuale nxjerr në sipërfaqe stigmatizimin nga shoqëria, paragjykimet, etiketimet dhe tabutë, siç edhe u përmend më lartë. Nga gjithsej 75 të anketuar, 29% ose 22 prej tyre theksojnë mosbesimin ndaj sistemit me përgjigjen se raportimi nuk do të ketë efekt, ndërsa 20% ose 15 të anketuar nuk do të raportonin për shkak të mosbesimit në institucionin ku do ta kishin bërë këtë. Te 17% ose 13 të anketuar, arsyeja kryesore është frika e hakmarrjes nga personi që është në pozitë të rëndësishme në arsimin e lartë. 12% ose 9 të anketuar nuk do të raportonin rastin sepse do të mbizotëronte turpi dhe paragjykimi nga rrethi, ndërsa 13% ose 10 të anketuar nuk do të raportonin nga frika se mos paragjykohehin se vetë janë fajtorë ose kanë dhënë shkas për zhvatje seksuale.

Grafiku 14 Pse nuk do të kishit raportuar zhvatjen për shërbime seksuale?



Këto të dhëna tregojnë se shoqëria jonë ka nevojë urgjente për më shumë angazhim dhe përkushtim në krijimin e politikave dhe zbatimin e ligjeve, për të krijuar më shumë besim tek institucionet e sistemit.

Trajtimi i pasojave që vështirësojnë jetën e viktimës së zhvatjes për shërbime seksuale është sigurisht edhe përgjegjësi e shtetit.

Është interesant fakti se duke i parë të dhënat në kontekst të gjinisë së të anketuarve, tek studentet ka një numër më të madh të përgjigjeve se denoncimi nuk do të kishte efekt (meshkujt 18%; femrat 38%) dhe për shkak të turpit nga rrethi (meshkujt 6%; femrat 17%). Te studentët meshkuj më shumë përgjigje argumentohen për faktin se nuk i besojnë institucionit (meshkujt 30%, femrat 12%). Duke pasur parasysh se për këtë pyetje u anketuan gjithsej 75 veta, të dhënat duhet të merren vetëm si indikatorë.

Gjithashtu duke i parë përgjigjet e të anketuarve nga prizmi i përkatësisë së tyre etnike, vërehet se te studentët e bashkësisë etnike shqiptare mbizotërojnë përgjigjet: turp nga mjedisi (maqedonasit 6%, shqiptarët 17%), frikë nga paragjykimi (maqedonasit 9%, shqiptarët 17%) dhe frikë nga hakmarrja (maqedonasit 9%, shqiptarët 24%). Nga ana tjetër, te studentët maqedonas mbizotërojnë përgjigjet që kanë të bëjnë me mosbesimin në institucion (maqedonasit 39%, shqiptarët 5%). Sërish duhet theksuar se për shkak të numrit të vogël të të anketuarve, këto të dhëna mund të merren vetëm si indikatorë të dukurisë, pa gjeneralizuar gjithë grupin e synuar për hulumtim.


8. Raportimi i mbrojtur

Bazuar në Ligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve, një raportim i mbrojtur është një raportim që përcjell një dyshim ose njohuri **të arsyeshme** se është kryer, është duke u kryer ose ka gjasa të kryhet një vepër penale ose vepër tjetër e paligjshme ose e palejueshme, që dëmton ose kërcënon interesin publik.

Ky ligj definon raportimin e mbrojtur, të drejtat e sinjalizuesve, si dhe veprimet dhe detyrat e institucioneve, përkatësisht të subjekteve juridike në lidhje me raportimin e mbrojtur dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.

Është shqetësues fakti që madje 70% e studentëve të anketuar nuk janë të informuar për mundësinë e raportimit të mbrojtur në fakultetin e tyre. Vetëm një e treta e të anketuarve kanë dëgjuar për ekzistimin e një shërbimi të tillë, gjë që tregon qartë se fakultetet nuk kanë ndërmarrë masat e nevojshme për të informuar studentët për ekzistimin e këtyre shërbimeve.

Grafiku 15 A keni dëgjuar për mundësinë e raportimit të mbrojtur në fakultetin tuaj (ku mund të raportoni dyshime ose njohuri se është kryer, po kryhet ose ka mundësi të kryhet një vepër penale ose sjellje tjetër e paligjshme)?




Përkundër faktit se vetëm një e treta e të anketuarve kanë dëgjuar për raportim të mbrojtur në fakultet, vërehet se në mesin e studentëve të bashkësisë etnike shqiptare kjo përqindje është më e lartë në krahasim me kolegët e tyre të tjerë.

		Përkatësia etnike			Gjithsej
		Maqedonas	Shqiptarë	Bashkësi më të vogla etnike	
A keni dëgjuar për mundësinë e raportimit të mbrojtur në fakultetin tuaj?	Po	28,1 %	37,5 %	15,4 %	30,0 %
	Jo	71,9 %	62,5 %	84,6 %	70,0 %
		100,0 %	100,0 %	100,0 %	100,0 %

Mendimet e të anketuarve në lidhje me gjininë e preferuar të personit të caktuar ku mund të denoncohet korrupsioni janë mjaft të ndara. Më shumë se gjysma e të anketuarve (54%) deklarojnë se nuk do të kishin problem nëse personi i emëruar do të ishte mashkull, por 45% e të anketuarve do të preferonin ta denonconin rastin korruptiv te një femër.

Grafiku 16 (Nëse personi i emëruar është mashkull), a do të ishte më mirë nëse personi i emëruar ku mund të denoncohet rasti korruptiv të jetë një femër?



Përgjigjet e të anketuarve, parë nga prizmi i të dhënave demografike, tregojnë se për 2/3 e studentëve meshkuj nuk ka rëndësi nëse personi i caktuar ku mund të denoncohet korrupsioni do të ishte një femër. Mirëpo, tek studentet, mendimi është i ndarë: 56% e tyre kanë theksuar se do të ishte më mirë nëse personi i caktuar ku mund të denoncohet korrupsioni të ishte një femër.

		GJINIA		Gjithsej
		Meshkuj	Femra	
(Nëse personi i emëruar është mashkull), a do të ishte më mirë nëse personi i emëruar ku mund të denoncohet rasti korruptiv të jetë një femër?	Po	30,7 %	55,7 %	45,6 %
	Jo	69,3 %	44,3 %	54,4 %
		100,0 %	100,0 %	100,0 %

Gjithashtu vërehet se për studentët që i përkasin bashkësisë etnike shqiptare, është më e rëndësishme që personi i caktuar për të denoncuar korrupsionin të jetë një femër.


		Përkatësia etnike			Gjithsej
		Maqedonas	Shqiptarë	Bashkësi më të vogla etnike	
(Nëse personi i emëruar është mashkull), a do të ishte më mirë nëse personi i emëruar ku mund të denoncohet rasti korruptiv të jetë një femër?	Po	37,7 %	73,0 %	11,5 %	45,6 %
	Jo	62,3 %	27,0 %	88,5 %	54,4 %
		100,0 %	100,0 %	100,0 %	100,0 %

9. Njohuritë për format e veçanta të korrupsionit

Shumica e të anketuarve besojnë se zhvatja për shërbime seksuale si një formë specifike e korrupsionit nuk njihet dhe nuk dallohet mjaftueshëm në publik – në diskutime, në politika dhe në legjislacionin vendas. Konkretisht, të dhënat e grumbulluara se “pak” ose “shumë pak” dihet për këtë temë, përfaqësojnë mbi 70% të përgjigjeve të të anketuarve. Kjo paraqet një sinjal të qartë se duhet gjetur mekanizma për të nxitur diskutimin, për të monitoruar situatën dhe për të informuar publikun për temat që kanë të bëjnë me zhvatjen për shërbime seksuale. Përgjigjet e 13,5% të të anketuarve që besojnë se në vendin tonë nuk dihet aspak për zhvatjen seksuale si formë korrupsioni, tregon se publiku nuk bën dallimin e aspekteve gjinore të korrupsionit. Vetëm 22% e të anketuarve konsiderojnë se opinioni publik mjaftueshëm njih dhe dallon zhvatjen seksuale si formë korrupsioni.

Është e rëndësishme të theksohet se pavarësisht faktit se 9 nga 10 të anketuar e njohin ekzistencën e shantazhimit seksual si një formë korrupsioni, ndërsa 7 nga 10 të anketuar besojnë se kjo ndodh në arsimin e lartë, prapëseprapë shumica beson se për të flitet pak ose aspak në diskutime, politika dhe është pak e përfshirë në legjislacionin vendas.


Grafiku 17 A mendoni se format specifike të korrupsionit në arsimin e lartë (si zhvatja seksuale) mjaftueshëm njihen dhe dallohen nga publiku – në diskutime, politika, në legjislacionin vendas?



Më poshtë paraqiten deklaratat e të anketuarve lidhur me aktivitete konkrete për të luftuar zhvatjen seksuale si formë korrupsioni.

Përgjigjet tregojnë se të anketuarit do të ishin më të gatshëm të dërgonin një denoncim anonim në një institucion të jashtëm përkatës (73%), e një përqindje e ngjashme do të pranonin t'i dërgonin një denoncim anonim personit të caktuar të fakulteteve për raportim të mbrojtur (68%). Nëse është e nevojshme, rreth gjysma e të anketuarve do të dëshmonin para një autoriteti kompetent (51%), por vetëm një e katërta e të anketuarve (26%) janë të gatshëm të flasin publikisht, t'i drejtohen mediave ose portaleve.

Grafiku 18 Ju lutemi përshkruani gatishmërinë tuaj për angazhim në lidhje me luftën kundër korrupsionit në arsimin e lartë.




Në përgjigjet e të anketuarve lidhur me gatishmërinë për angazhim në luftën kundër korrupsionit, parë nga prizmi i përkatësisë etnike, vërehet se studentët e etnitetit maqedonas, nëse është e nevojshme, shprehin gatishmëri më të madhe për të dëshmuar para një organi kompetent, për të folur publikisht dhe për të dërguar një raport anonim në një institucion të jashtëm përkatës.

	Maqedonas	Shqiptarë	Bashkësi më të vogla etnike
Nëse është e nevojshme, do të kisha dëshmuar para një organi kompetent	57,1 %	34,5 %	42,3 %
Jam i gatshëm/e gatshme të flas publikisht në një media, në internet	29,9 %	17,0 %	7,7 %
Do ta kisha dërguar denoncimin anonim te personi i caktuar i fakultetit për raportim të mbrojtur	68,2 %	69,0 %	46,2 %
Do t'i kisha dërguar denoncim anonim një institucioni të jashtëm përkatës	79,9 %	55,0 %	65,4 %

10. Çrrënjësja e korrupsionit

Për sa i përket pyetjes nëse është e mundur të çrrënjësohet korrupsioni në arsimin e lartë, përgjigjet tregojnë se të anketuarit kanë shpresë për mundësinë e ballafaqimit me korrupsionin. Më shumë se një e treta e të anketuarve (31.2%) besojnë se korrupsioni mund të çrrënjësohet plotësisht ose të zvogëlohet dukshëm, ndërsa 42% e tyre besojnë se mund të zvogëlohet deri në një shkallë të caktuar. Megjithatë, pothuajse një e katërta e të anketuarve (23%) besojnë se korrupsioni në arsimin e lartë nuk mund të zvogëlohet aspak.

Grafiku 19 A është e mundur të çrrënjësohet korrupsioni në arsimin e lartë?



Në përgjigjet e të anketuarve lidhur me çrrënjësien e korrupsionit në arsimin e lartë, parë nga prizmi i përkatësisë etnike të të anketuarve, vihet re se studentët që i përkasin bashkësisë etnike shqiptare shprehin më shumë optimizëm se korrupsioni mund të zvogëlohet dukshëm.

	Përkatësia etnike			Gjithsej	
	Maqedonas	Shqiptarë	Bashkësi më të vogla etnike		
A mund të çrrënjësohet korrupsioni në arsimin e lartë?	Korrupsioni nuk mund të zvogëlohet aspak	26,9 %	10,5 %	30,8 %	22,9 %
	Korrupsioni mund të zvogëlohet deri në një shkallë të caktuar	40,3 %	45,5 %	50,0 %	41,9 %
	Korrupsioni mund të zvogëlohet dukshëm	19,1 %	31,0 %	7,7 %	21,7 %
	Korrupsioni mund të çrrënjësohet krejtësisht	9,9 %	8,5 %	7,7 %	9,5 %
	Pa përgjigje	3,8 %	4,5 %	3,8 %	4,0 %
	100,0 %	100,0 %	100,0 %	100,0 %	

GJETJET KRYESORE

Ndikimi i korrupsionit

- ◆ Shtatë nga dhjetë të anketuar pajtohen se korrupsioni ka një efekt po aq negativ si te femrat, ashtu edhe te meshkujt.
- ◆ Një nga dhjetë të anketuar besojnë se korrupsioni ndikon më shumë te meshkujt, ndërsa 14% besojnë se korrupsioni ndikon më shumë te femrat.

Korrupsioni si problem

- ◆ Dy të tretat e të anketuarve zakonisht e shohin korrupsionin në arsimin e lartë si një problem **të madh**.
- ◆ 19% e të anketuarve kanë theksuar se korrupsioni është një problem i vogël, ndërsa për 3% të të anketuarve korrupsioni nuk është aspak problem në arsimin e lartë.
- ◆ Ata të anketuar që janë përgjigjur se korrupsioni paraqet problem në arsimin e lartë, gjithashtu u është kërkuar që të vlerësojnë intensitetin e problemit në një shkallë nga 1 deri në 9, ku 1 paraqet intensitetin më të ulët dhe 9 intensitetin më të lartë. Nota mesatare e përgjigjeve të tyre është **6.87**, që paraqet një intensitet të lartë të pranisë së problemit.

Nxitja e korrupsionit dhe nënshtrimi ndaj tij

- ◆ Nga gjithsej gjashtë opsionet e ofruara si nxitës të mundshëm të korrupsionit në arsimin e lartë, studentët besojnë se korrupsionin në masën më të madhe e nxisin kuadri pedagogjik (profesorë, docentë, asistentë), ndërsa studentët e nxisin atë më së paku. Duke pasur parasysh se vetë të anketuarit janë studentë, ekziston mundësia që të ndikohet në përgjigjet e tyre lidhur me mundësinë për nënshtrim ndaj korrupsionit.
- ◆ Mbi 77% e të anketuarve theksuan se nuk i njohin aspektet gjinore të korrupsionit, gjegjësisht si burrat ashtu edhe gratë njëlloj i nënshtrohen korrupsionit.

Përvoja korrupsioni

- ◆ Se profesori/profesoresha nuk ka kërkuar drejtpërdrejtë para, dhuratë apo shërbim por përmes një ndërmjetësi kanë deklaruar 13% të studentëve.
- ◆ Me vetëiniciativë kanë dhënë ryshfet gjatë studimeve 11% e studentëve.
- ◆ 50 studentëve, gjegjësisht 6,2% të të anketuarve u ka ndodhur që gjatë studimeve, një person nga administrata t'u kërkojë para, dhuratë apo shërbim.
- ◆ Profesori/profesoresha t'u kërkojë para, dhuratë apo shërbim në mënyrë të drejtpërdrejtë u ka ndodhur gjithsej 47 studentëve, gjegjësisht 5,9% e të anketuarve.
- ◆ 21 studentë kanë theksuar se kanë pasur përvojë që një drejtues fakulteti t'u kërkojë para, dhuratë ose shërbim.

Zhvatja për shërbime seksuale

- ◆ Zhvatja për shërbime seksuale nga punonjësit e arsimit të lartë me qëllim të ofrimit të një shërbimi si formë korrupsioni njihet nga 89% e të anketuarve.
- ◆ Vetëm **një nga dhjetë** të anketuar beson se zhvatja për shërbime seksuale nga punonjësit e arsimit të lartë me qëllim të ofrimit të një shërbimi **nuk përfaqëson një formë korrupsioni**.
- ◆ Rreth 78% e të anketuarve besojnë se zhvatja seksuale ndodh si një formë korrupsioni në arsimin e lartë, nga të cilët 16,4% kanë theksuar se kjo ndodh shumë shpesh.
- ◆ Situatat më të shpeshta në të cilat personat në pozita të rëndësishme në arsimin e lartë kërkojnë shërbime seksuale janë: që të kalohet një provim (77%) dhe për një notë më të lartë (42%).

Përvojat personale

- ◆ Rreth **65%** e të anketuarve nuk shprehin haptas se a bëhet fjalë **për përvojë personale apo të një personi tjetër** në lidhje me zhvatjen për shërbime seksuale si formë korrupsioni.
- ◆ Një e pesta e të anketuarve kanë theksuar se **nuk kanë pasur përvojë personale**, por njohin dikë që kishte kaluar nëpër këtë formë korrupsioni dhe **3%** e të anketuarve (21 të anketuar) që **personalisht** kanë përjetuar zhvatjen për shërbime seksuale nga një person në pozicion të rëndësishëm në arsimin e lartë (profesor, shef katedre, dekan...).
- ◆ Nga 21 të anketuar që personalisht kanë pasur përvojë me zhvatje për shërbime seksuale, vetëm 7 të anketuar kanë denoncuar rastin.
- ◆ Nga 193 të anketuar që kanë një mike me përvojë zhvatjeje për shërbime seksuale, vetëm 26 të anketuar kanë deklaruar se mikesha e tyre ka denoncuar rastin.

- ◆ Nga 696 të anketuar që paraprakisht kishin deklaruar se nuk kanë përvojë me zhvatje për shërbime seksuale, 77% e tyre do të kishin denoncuar një rast të këtillë nëse do t'u kishte ndodhur diçka e tillë në të ardhmen, 11% nuk do të denonconin rastin, ndërsa 12% nuk mundeshin t'i përgjigjen kësaj pyetjeje.
- ◆ Ata të anketuar që nuk do të denonconin zhvatjen për shërbime seksuale nëse do t'u ndodhte në të ardhmen, kërkojnë nuk do ta bënin këtë sepse besojnë se nuk do të kishte asnjë efekt.
- ◆ Nga ata të anketuar (578) që paraprakisht kishin deklaruar se do të raportonin zhvatjen për shërbime seksuale, 78% e tyre do ta bënin këtë në një institucion të jashtëm përkatës, ndërsa 22% e tyre do të raportonin në institucionin ku ka ndodhur rasti.
- ◆ Dy të tretat e të anketuarve që do të denonconin rastin në një institucion të jashtëm, do ta bënin këtë në polici.
- ◆ Gjysma e të anketuarve që do ta raportonin rastin brenda institucionit, do ta bënin këtë te dekani.

Raportimi i mbrojtur

- ◆ Rreth një e treta e të anketuarve kanë dëgjuar për mundësinë e raportimit të mbrojtur në fakultet.
- ◆ Mendimi i të anketuarve është i ndarë lidhur me faktin nëse do të ishte më mirë personi i caktuar ku mund të raportohet për korrupsion në kuadër të fakultetit, të ishte një femër.

■ Njohuritë për format e veçanta të korrupsionit

- ◆ Mbi 70% e përgjigjeve (të dhëna të grumbulluara, “pak” ose “aspak”) të të anketuarve konsiderojnë se zhvatja për shërbime seksuale si një formë e veçantë korrupsioni, **nuk njihet dhe dallohet mjaftueshëm në publik** – në diskutime, në politikat dhe legjislacionin vendas.
- ◆ Mbi 73% e të anketuarve shprehin gatishmërinë për të dërguar **një denoncim anonim në institucionin përkatës**, si një angazhim në lidhje me luftën kundër korrupsionit në arsimin e lartë.
- ◆ Në shenjë gatishmërie për t’u angazhuar në luftën kundër korrupsionit në arsimin e lartë, dy të tretat e të anketuarve **do t’i dërgonin një denoncim anonim personit të caktuar për raportim të mbrojtur në fakultet**.
- ◆ Gjysma e të anketuarve **do të kishin dëshmuar para një organi kompetent** nëse ekziston nevoja për këtë.
- ◆ Vetëm 26% e të anketuarve shprehin gatishmërinë **publikisht të flasin për luftën kundër korrupsionit në arsimin e lartë**.

■ Çrrënjosja e korrupsionit në arsimin e lartë

- ◆ Rreth 73% e të anketuarve shpresojnë se lufta kundër korrupsionit në arsimin e lartë mund të kontribuojë në zvogëlimin e tij.
- ◆ Mbi 41% besojnë se korrupsioni mund të zvogëlohet deri në një shkallë të caktuar, ndërsa dy herë më pak (22%) besojnë se mund të zvogëlohet dukshëm.

- ◆ Një nga dhjetë të anketuar besojnë se korrupsioni mund të çrrënjoset plotësisht.
- ◆ 23% e të anketuarve besojnë se korrupsioni në arsimin e lartë nuk mund të zvogëlohet aspak.

**RAPORT NGA HULUMTIMI I
PERCEPTIMIT TË FORMAVE
GJINORE TË KORRUPSIONIT NË
ADMINISTRATËN PUBLIKE
NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT**

-administratë publike-

gusht, 2022

Shkup

REZYME

Barazia gjinore nënkupton që femrat dhe meshkujt kanë të drejta dhe mundësi të barabarta për të realizuar potencialin e tyre individual, duke kontribuar kështu në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit të tyre, e nga pjesëmarrja e tyre në shoqëri të kenë edhe përfitim të caktuar.

Korrupsioni paraqet rrezik për të drejtat e njeriut dhe kontribuon në rritjen e diskriminimit social, kulturor, politik dhe institucional, dhe në të njëjtën kohë parandalon arritjen e barazisë gjinore, përkeqëson dallimet gjinore dhe thekson pabarazinë sociale për qasje në shërbimet publike.

Hulumtimet bashkëkohore përpiqen të shpjegojë dallimet midis femrave dhe meshkujve në kuptimin dhe përjetimin e korrupsionit, përkatësinë gjinore të atyre që janë përfshirë në akte korrupsioni, dallimet në "llojin e valutës" së përdorur nga femrat dhe meshkujt për të paguar për aktet e korrupsionit, si dhe ndikimin e ndryshëm të korrupsionit në jetën e përditshme të meshkujve dhe femrave.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut mungojnë të dhëna empirike lidhur me format gjinore të korrupsionit, ndikimin e formave gjinore të korrupsionit, rezistencën ndaj këtyre formave, etj. Pas kryerjes së një sondazhi mbarëkombëtar në vitin 2021 ku për ekzemplar hulumtimi u morën femrat në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për të parë perceptimin e tyre në lidhje me format e korrupsionit me bazë gjinore, veçanërisht zhatjen seksuale – si më të cenuar nga kjo formë korrupsioni u detektuan dy sektorë shoqërorë, e që janë: arsimiti i lartë dhe administrata publike.

Mungesa e të dhënave empirike lidhur me format gjinore të korrupsionit, veçanërisht për situatën në administratën publike, ishte një nxitje shtesë për realizimin e këtij hulumtimi.

Për të siguruar të dhënat përkatëse, u krye një anketë e një pjese të popullatës që punon në administratën shtetërore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Gjetjet e këtij hulumtimi mund të përdoren për diskutime të mëtejshme me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit të politikëbërësve, për nevojën e institucionalizimit dhe kriminalizimit të formave gjinore të korrupsionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

RAPORTI METODOLOGJIK

Ky hulumtim është realizuar nga Instituti TIM (në tekstin e mëtejme "Instituti") që ka përdorur për mostër një pjesë të popullatës që punon në administratën publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Hulumtimi është realizuar me gjithsej 800 të anketuar, nga gjithsej 132.088 persona që janë në marrëdhënie pune në sektorin publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut në 1.346 institucione aktive (numri më i madh i të punësuarve është në arsim me 33 %, pastaj në shëndetësi 19%, administrata shtetërore me 13%, veprimtaritë komunale të ndërmarrjeve publike me 9% nga numri i përgjithshëm i punonjësve), në përputhje me të dhënat më të fundit me të cilat disponon dhe janë publikuar në Raportin e Regjistrimit¹ të të punësuarve në Sektorin Publik për vitin 2021 nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës².

Për qëllimet e hulumtimit është përdorur modeli i intervistës telefonike CATI.

Lloji i mostrës

Në fazën e modelimit të mostrës, Instituti mori parasysh: gjininë, moshën, nivelin arsimor dhe përkatësinë etnike të personave që janë në marrëdhënie pune në sektorin publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

¹ <https://www.mioa.gov.mk/?q=mk/node/3226>.

² Duhet pasur parasysh se nga numri i përgjithshëm i të punësuarve në sektorin publik, këtu nuk janë përfshirë Armata e Republikës së Maqedonisë së Veriut, zyrtarët e autorizuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe organi në kuadër të ministrisë, Agjencia e Zbulimit, Agjencia për Siguri Kombëtare dhe organi në kuadër të Ministrisë së Financave – Administrata e Policisë Financiare (gjithsej 19311 veta).

Përzgjedhja e të anketuarve

Çdo intervistues duhet të bëjë të paktën tre përpjekje për të realizuar kontaktin telefonik me amvisërinë e përzgjedhur. Nëse edhe pas tre përpjekjeve gjatë punës nuk vendoset kontakti me familjen, kontaktohet një amvisëri tjetër sipas procedurës së paracaktuar për përzgjedhje të amvisërisë.

Anketuesit regjistrojnë rezultatet e të gjitha përpjekjeve për të vendosur kontakt në të ashtuquajturën Listë të Kontakteve.

Në një amvisëri mund të anketohet vetëm një person i përzgjedhur.

Sistemi për kontrollin e cilësisë

Rreth 25% e intervistave të kryera i nënshtrohen kontrollit.

Rrjeti i anketimit dhe mbikëqyrjes

Hulumtimi u realizua nga një rrjet i zhvilluar intervistuesish me përvojë (operatorë telefonikë), në gjuhën maqedonase dhe shqipe.

Në këtë projekt ishin të angazhuar 34 intervistues me përvojë.

Kohëzgjatja e hulumtimit

Para fillimit të anketës telefonike, të gjithë intervistuesit ndoqën një trajnim teorik mbi metodologjinë dhe procedurën e punës, i cili përfshinte një shpjegim lidhur me kuptimin dhe zbatimin e procedurave të mëposhtme:

- ◆ Përzgjedhjen e amvisërisë;
- ◆ Përzgjedhjen e të anketuarit;
- ◆ Shpjegimin e metodës së plotësimit të pyetësorit programatik.


Hulumtimi u realizua nga data 09.08.2022 deri më 16.08.2022.

Për përpunimin dhe analizimin e të dhënave të siguruara është përdorur softueri profesional për përpunimin e të dhënave statistikore SPSS për Windows.


Për përgatitjen e raportit, grafikëve dhe tabelave u përdorën SPSS për Windows dhe Microsoft Office për Windows (Word dhe Excel).

STRUKTURA DEMOGRAFIKE E TË ANKETUARVE


GJINIA




MOSHA



PËRKATËSIA ETNIKE



ARSIMI



1. Korrupsioni si problem

Pesha e problemeve që shkakton korrupsioni ndikon negativisht në demokracinë, drejtësinë, zhvillimin ekonomik dhe social, respektimin e të drejtave të njeriut, si dhe në vlerat morale dhe standardet etike. E gjithë kjo ka një ndikim serioz në stabilitetin dhe sigurinë e vendit.


Vetë fjala korrupsion nënkupton shpërdorim të detyrës apo pozitës zyrtare dhe pushtetit, me qëllim të përfitimit personal apo për dikë tjetër. Në shoqëritë demokratike llogaridhënia e bartësve të funksioneve publike është rregull. Ata duhet të jenë persona me integritet dhe rezistencë të fortë ndaj korrupsionit, në mënyrë që të mund të veprojnë në funksion të mbrojtjes së interesit publik dhe të fitojnë e ruajnë besimin e qytetarëve.

Pyetja e parë në anketë i referohet perceptimit të përhapjes së korrupsionit në vendin e punës që ka personi në administratën publike.

Vihet re se gati një e katërta, gjegjësisht 23% e të anketuarve kanë theksuar se korrupsioni është një problem i madh, 39% e tyre kanë thënë se është një problem i vogël, ndërsa për një të tretën e të anketuarve korrupsioni nuk përbën aspak problem në vendin e tyre të punës në administratën publike.

Nga kjo mund të konstatohet se shumica e të anketuarve (62%) pajtohen se korrupsioni në administratën publike në vendin tonë paraqet një **problem**, ndërsa katër nga dhjetë të anketuar e konsiderojnë atë si një problem të **vogël**.

Grafiku 1 Sa është problem korrupsioni në vendin tuaj të punës?



Përgjigjet e të anketuarve, parë nga prizmi i vendit të tyre të punës, tregojnë se punonjësit e shëndetësisë e potencojnë zëshëm institucionin e tyre si një vend ku korrupsioni paraqet një problem të madh. Pas tyre vjen administrata publike në nivel vendor, ku 22% e të anketuarve të punësuar në institucionet në nivel vendor mendojnë se korrupsioni është një problem i madh. Në vendin e tretë, 18% e të anketuarve të punësuar në arsim, besojnë se korrupsioni është një problem i madh në vendin e tyre të punës.

Tabela Nr. 1.

Sa është problem korrupsioni në vendin tuaj të punës?	
	Problem i madh
Shëndetësi	28,50 %
Administratë publike – në nivel lokal	22,00 %
Arsim	18,30 %
Administratë publike – në nivel qendror	14,00 %
Polici	11,30 %
Gjyqësi	4,30 %
Mbrojtje sociale	1,60 %

Gjithashtu vërehet se të anketuarit që u përkasin komuniteteve më të vogla etnike thonë se korrupsioni paraqet problem të madh, për dallim nga të tjerët, ndërsa pjesëtarët e komunitetit etnik shqiptar më shpesh nga të tjerët vlerësojnë se korrupsioni është problem më i vogël.


Tabela Nr. 2.

		Përkatësia etnike			Gjithsej
		Maqedonas	Shqiptarë	Bashkësi më të vogla etnike	
Sa është problem korrupsioni në vendin tuaj të punës?	Problem i madh	22,9 %	22,6 %	31,6 %	23,2 %
	Problem i vogël	38,0 %	46,8 %	21,1 %	39,3 %
	Aspak nuk është problem	34,4 %	15,3 %	34,2 %	29,8 %
	Refuzon të përgjigjet	2,4 %	7,4 %	5,3 %	3,7 %
	Nuk e di	2,3 %	7,9 %	7,9 %	3,9 %
Gjithsej:		100,0 %	100,0 %	100,0 %	100,0 %

2. Nxitja e korrupsionit dhe nënshtrimi ndaj tij

Rreth dy të tretat e të anketuarve (68%) janë deklaruar se **nuk i njohin aspektet gjinore të korrupsionit**, respektivisht janë të mendimit se si burrat ashtu edhe gratë i nënshtrohen korrupsionit në mënyrë të njëjtë. Rreth 15% e të anketuarve besojnë se gratë janë më pak të prirura ndaj korrupsionit se sa burrat, por pothuajse një nga dhjetë të anketuar mendojnë të kundërtën, gjegjësisht se gratë i nënshtrohen korrupsionit më shumë se burrat.

Grafiku 2 Cila nga pohimet e mëposhtme përshkruan më mirë gjendjen e korrupsionit në administratën publike?




Përkundër faktit se numri më i madh i të anketuarve besojnë se korrupsioni prek njësoj si meshkujt ashtu edhe femrat, duke marrë parasysh përgjigjet përmes prizmit të karakteristikave demografike, nga femrat e anketuara vërehet se 6% më shumë besojnë se “korrupsioni ndikon më pak femrat”.

Tabela Nr. 3.

		Gjinia		Gjithsej
		Meshkuj	Femra	
Cila nga pohimet e mëposhtme përshkruan më mirë gjendjen e korrupsionit në administratën publike?	Gratë i nënshtrohen korrupsionit më pak	12,0 %	18,0 %	15,4 %
	Edhe femrat, edhe meshkujt i nënshtrohen korrupsionit njësoj	72,5 %	63,5 %	67,5 %
	Gratë i nënshtrohen korrupsionit më shumë	6,7 %	10,1 %	8,6 %
	Refuzon të përgjigjet	2,0 %	1,4 %	1,6 %
	Nuk e di	6,7 %	7,0 %	6,9 %
Gjithsej		100,0 %	100,0 %	100,0 %

Më shumë se gjysma (55%) e të anketuarve besojnë se femrat e punësuar në administratën publike janë po aq të korruptuara kur ato janë në pozita më të larta të pushtetit ose pozita drejtuese. Rreth 29% e të anketuarve besojnë se femrat janë më pak të korruptuara kur janë në pozita më të larta, por një nga dhjetë të anketuar megjithatë mendon se ato janë më të korruptuara kur janë në poste më të larta ose drejtuese.

Grafiku 3 A do të kishit thënë se femrat e punësuar në administratën publike janë më shumë/më pak ose po aq të korruptuara kur janë në pozita më të larta pushteti/pozita drejtuese?



Përgjigjet e të anketuarve shqyrtuar përmes prizmit të gjinisë së tyre, tregojnë se femrat në një masë më të madhe theksojnë se, për dallim nga meshkujt, femrat e punësuar në administratën publike janë më pak të korruptuara kur janë në pozita më të larta pushteti/pozita drejtuese.

Tabela Nr. 4.

		Gjinia		Gjithsej
		Meshkuj	Femra	
A do të kishit thënë se femrat e punësuar në administratën publike janë më shumë/më pak ose po aq të korruptuara kur janë në pozita më të larta pushteti/pozita drejtuese?	Më shumë të korruptuara	10,9 %	10,1 %	10,5 %
	Më pak të korruptuara	22,7 %	33,6 %	28,7 %
	Njësoj të korruptuara	61,9 %	50,2 %	55,4 %
	Refuzon të përgjigjet	1,1 %	1,1 %	1,1 %
	Njësoj	3,4 %	5,0 %	4,2 %
Gjithsej:		100,0 %	100,0 %	100,0 %

Përgjigjet për të njëjtën pyetje parë nga prizmi i pozicionit të punës së të anketuarve, tregojnë se ata të anketuar që janë në pozita drejtuese më shpesh theksojnë se gratë janë më pak të korruptuara kur janë në pozita drejtuese.

Tabela Nr. 5.

		A jeni në pozitë drejtuese?		Gjithsej
		Po	Jo	
A do të kishit thënë se femrat e punësuara në administratën publike janë më shumë/më pak ose po aq të korruptuara kur janë në pozita më të larta pushteti/pozita drejtuese?	Më shumë të korruptuara	8,8 %	10,7 %	10,5 %
	Më pak të korruptuara	37,5 %	27,7 %	28,7 %
	Njësoj të korruptuara	50,0 %	56,0 %	55,4 %
	Refuzon të përgjigjet	1,3 %	1,1 %	1,1 %
	Nuk e di	2,5 %	4,4 %	4,2 %
Gjithsej:		100,0 %	100,0 %	100,0 %

Është interesante të shqyrtohen përgjigjet e kësaj pyetjeje, por vetëm përmes prizmit të të anketuarave që janë pjesë e hulumtimit. Nga gjithsej 444 të anketuara, 45 janë në pozita drejtuese. Prej tyre, vetëm 4 kanë thënë se kur një femër është në një pozicion më të lartë pushteti, ajo është më e korruptuar. Pjesa tjetër kishte një pikëpamje të ndarë, duke deklaruar se femrat janë më pak të korruptuara ose se janë po aq të korruptuara.

Tabela Nr. 6.


Janë anketuar vetëm femra		A jeni në pozitë drejtuese?		Gjithsej
		Po	Jo	
A do të kishit thënë se femrat e punësuara në administratën publike janë më shumë/më pak apo njësoj të korruptuara kur janë në pozita më të larta pushteti/pozicione drejtuese?	Më shumë të korruptuara	4	41	45
	Më pak të korruptuara	20	129	149
	Njësoj të korruptuara	19	204	223
	Refuses to answer	0	5	5
	Nuk e di	2	20	22
Gjithsej:		45	399	444

3. Zhvatja e shërbimeve seksuale nga punonjës të administratës shtetërore ndaj qytetarëve si përdorues të shërbimeve

Format e korrupsionit mund të jenë të ndryshme. Korrupsioni në thelb si qëllim përfundimtar ka realizimin e një përfitimi të caktuar. Zhvatja e shërbimeve seksuale nga punonjës të administratës publike në këmbim të dhënies së një shërbimi **njihet si formë korrupsioni nga 61% e të anketuarve, të punësuar në administratën publike**. Të anketuarit patën mundësinë në një shkallë nga 1 deri në 5 (ku 1 do të thotë “aspak nuk pajtohem” dhe 5 do të thotë “plotësisht pajtohem”), të shprehin mendimin e tyre lidhur me deklaratën: “Zhvatja e shërbimeve seksuale paraqet një formë korrupsioni nëse shfrytëzohet për të siguruar një lloj shërbimi publik në kuadër të administratës publike”. Rreth 42% e të anketuarve janë plotësisht dakord me deklaratën, ndërsa 19% e të anketuarve pajtohen deri në një shkallë të caktuar.

Për dallim nga këta të anketuar, 11% mendojnë se zhvatja e shërbimeve seksuale për sigurimin e një shërbimi në kuadër të administratës publike nuk paraqet formë korrupsioni, ndërsa nga ana tjetër, 8% shprehin dyshim të vogël lidhur me këtë. Një e pesta (21%) e të anketuarve të punësuar në administratën publike kanë një qëndrim neutral në lidhje me njohjen e zhvatjes së shërbimeve seksuale si formë korrupsioni. Këta të anketuar as pajtohen dhe as nuk kundërshtojnë deklaratën më sipër.

Grafiku 4 Në një shkallë nga 1 deri në 5 (ku 1 do të thotë aspak nuk pajtohem dhe 5 do të thotë plotësisht pajtohem), sa jeni dakord me deklaratën: “Zhvatja e shërbimeve seksuale për të kryer një shërbim brenda administratës publike paraqet një formë korrupsioni”?



Duke i shqyrtuar përgjigjet e të anketuarve nga prizmi i përkatësisë së tyre etnike, vihet re se pothuajse dyfishi i të anketuarve – pjesëtarë të komunitetit etnik shqiptar, në raport me të anketuarit maqedonas etnik, pajtohen plotësisht se zhvatja e shërbimeve seksuale për realizimin e një shërbimi në kuadër të administratës publike paraqet një formë korrupsioni.

Tabela Nr. 7.


		Përkatësia etnike			Gjithsej
		Maqedonas	Shqiptarë	Bashkësi më të vogla etnike	
“Zhvatja e shërbimeve seksuale për të kryer një shërbim brenda administratës publike paraqet një formë korrupsioni”.	Aspak nuk pajtohem	14,5 %		18,4 %	11,2 %
	2	6,5 %	11,1 %	10,5 %	7,7 %
	3	16,9 %	34,7 %	7,9 %	20,7 %
	4	14,0 %	31,6 %	23,7 %	18,6 %
	Pajtohem plotësisht	48,2 %	22,6 %	39,5 %	41,7 %
	Gjithsej:	100,0 %	100,0 %	100,0 %	100,0 %

4. Njohuritë për format specifike të korrupsionit

Shumica e të anketuarve besojnë se zhatja për shërbime seksuale si një formë specifike e korrupsionit nuk njihet dhe nuk dallohet mjaftueshëm në publik – në diskutime, në politika dhe në legjislacionin vendas. Konkretisht, të dhënat e grumbulluara se “pak” ose “shumë pak” dihet për këtë temë, përfaqësojnë mbi 60% të përgjigjeve të të anketuarve. Kjo paraqet një sinjal të qartë se duhet gjetur mekanizma për të nxitur diskutimin, për të monitoruar situatën dhe për të informuar publikun për temat që kanë të bëjnë me zhatjen për shërbime seksuale. Përgjigjet e 11% të të anketuarve që besojnë se në vendin tonë nuk dihet aspak për zhatjen seksuale si formë korrupsioni, tregon se publiku nuk bën dallimin e aspekteve gjinore të korrupsionit. Mbi një e treta e të anketuarve të punësuar në sektorin publik besojnë se opinioni publik mjaftueshëm njih dhe dallon zhatjen seksuale si formë korrupsioni.

Nuk ka dallime statistikisht domethënëse në përgjigjet e të anketuarve, parë nga prizmi i karakteristikave të tyre demografike, përkatësisht, një numër i barabartë i të anketuarve meshkuj dhe femra, si dhe pjesëtarë të komunitetit etnik maqedonase dhe shqiptar, ndajnë qëndrimin e njëjtë.


Grafiku 5 A mendoni se format specifike të korrupsionit si zhatja seksuale për të siguruar shërbime publike, mjaftueshëm njihen dhe dallohen nga publiku – në diskutime, politika, në legjislacionin vendas?



Kur të anketuarit e punësuar në administratën publike u pyetën se cilat janë gjasat që personat në pozicione të kërkojnë favore seksuale në vend se të përdorin forma tjera korrupsioni (para/ryshfet), numri më i madh i tyre theksojnë se kjo ndodh “ndonjëherë” (37 %). Rreth një e treta e 34% e të anketuarve kanë theksuar se këto janë situata “të rralla”, ndërsa 13% e të anketuarve dyshojnë plotësisht në mundësinë që njerëzit në pozita pushteti të kërkojnë favore seksuale në vend se të përdorin forma tjera korrupsioni (para/ryshfet).

Për dallim nga këta të anketuar, 14% theksojnë se kjo dukuri është e shpesh-të dhe 1% e të anketuarve besojnë se është një praktikë e vazhdueshme që personat në pozitë pushteti të kërkojnë favore seksuale në vend të formave tjera të korrupsionit.

Grafiku 6 Sipas mendimit tuaj, cilat janë gjasat që njerëzit në pozicione të kërkojnë favore seksuale, në vend të formave tjera të korrupsionit (para/ryshfet)?



Përgjigjet për të njëjtën pyetje, parë nga prizmi i pozicionit të punës së të anketuarve, tregojnë se ata të anketuar që janë në pozicione drejtuese në një masë më të madhe theksojnë se ndodh “rrallë” ose “ndonjëherë” që njerëzit në pozicione të kërkojnë favore seksuale, në vend të formave tjera të korrupsionit.

Tabela Nr. 8.

		A jeni në pozitë drejtuese?		Gjithsej
		Po	Jo	
Në një shkallë nga 1 deri në 5, sa mendoni se është e mundshme që njerëzit në pozicione të kërkojnë favore seksuale në vend të formave tjera të korrupsionit (para/ryshfet)?	Asnjëherë	15,0 %	12,5 %	12,7 %
	Rrallë	37,5 %	33,8 %	34,2 %
	Ndonjëherë	37,5 %	37,4 %	37,5 %
	Shpesh	10,0 %	14,6 %	14,1 %
	Vazhdimisht		1,7 %	1,5 %
	Gjithsej:	100,0 %	100,0 %	100,0 %

Të dhënat janë interesante kur shihen nga prizmi i pozicionit drejtues dhe gjinisë. Gjegjësisht, meshkujt në pozita drejtuese në masë më të madhe theksojnë se personat në pozita “rrallë” kërkojnë favore seksuale në vend të formave tjera të korrupsionit, në raport me të njëjtën përgjigje nga femrat në poste drejtuese. Por te meshkujt që nuk janë në poste drejtuese, vihet re përgjigjja “vazhdimisht” (2.8%), e cila mungon si përgjigje te meshkujt që janë në poste drejtuese.

Tabela Nr. 9.

A jeni në pozitë drejtuese?		Gjinia		Gjithsej	
		Meshkuj	Femra		
Po	Në një shkallë nga 1 deri në 5, sa mendoni se është e mundshme që njerëzit në pozicione të kërkojnë favore seksuale në vend të formave tjera të korrupsionit (para/ryshfet)?	Asnjëherë	14,3 %	15,6 %	15,0 %
		Rrallë	42,9 %	33,3 %	37,5 %
		Ndonjëherë	31,4 %	42,2 %	37,5 %
		Shpesh	11,4 %	8,9 %	10,0 %
		Total:	100,0 %	100,0 %	100,0 %
Jo	Në një shkallë nga 1 deri në 5, sa mendoni se është e mundshme që njerëzit në pozicione të kërkojnë favore seksuale në vend të formave tjera të korrupsionit (para/ryshfet)?	Asnjëherë	10,2 %	14,3 %	12,5 %
		Rrallë	32,0 %	35,3 %	33,8 %
		Ndonjëherë	40,7 %	34,8 %	37,4 %
		Shpesh	14,3 %	14,8 %	14,6 %
		Vazhdimisht	2,8 %	0,8 %	1,7 %
	Gjithsej:	100,0 %	100,0 %	100,0 %	

5. Prania e zhatjes seksuale në institucione


Nga të anketuarit e punësuar në administratën publike, ato në fushën e shëndetësisë konsiderojnë se zhatja seksuale si formë korrupsioni më shpesh ndodh në institucionet e tyre. e Përmbledhja e përgjigjeve “vazhdimisht” dhe “shpesh” përbën 23% të të anketuarve që kanë vërejtur shpërdorim të detyrës publike ose kompetencave me qëllim të përfitimit të shërbimeve seksuale (në raste kur një qytetar që i është drejtuar një punonjësi në administratën shtetërore dhe administratori ka zhvatur shërbime seksuale në këmbim të shërbimit të cilin ai e ka për detyrë ta sigurojë).

Më poshtë janë Institucionet ku poashtu rreth një e pesta e të anketuarve e shohin shfaqjen e zhatjes seksuale në vazhdimësi ose shpesh:

- ◆ Në gjyqësor, 22 % (përgjigje të përmbledhura “vazhdimisht” dhe “shpesh”);
- ◆ Në institucione publike në nivel qendror, 21 % (përgjigje të përmbledhura “vazhdimisht/” dhe “shpesh”);
- ◆ Në institucione publike në nivel vendor, 20 % (përgjigje të përmbledhura “vazhdimisht” dhe “shpesh”).

Institucionet e mbrojtjes sociale janë fushat në të cilat është regjistruar përqindja më e lartë e përgjigjeve në kategorinë “asnjëherë” – 22% dhe “rrallë” – 40%.

Grafiku 7 Sa shpesh mendoni se zhatja seksuale ndodh si një formë korrupsioni në institucionet e fushave si më poshtë (kur një qytetar i drejtohet një punonjësi në administratën publike dhe ai zhat shërbime seksuale në këmbim të një shërbimi që është i detyruar ta sigurojë)?



Situatat më të zakonshme në të cilat njerëzit në pozitë pushteti kërkojnë shërbime seksuale kur bëhet fjalë për punësim (30%) dhe për të shmangur ndëshkimin ose problemet që kanë ata që kanë kërkuar shërbimit (25%).

Një e pesta e të anketuarve besojnë se personat në një pozicion pushteti më së shpeshti kërkojnë shërbime seksuale në këmbim të një trajtimi më të mirë (21%) dhe për të përshpejtuar disa punë ose procedura që u nevojiten atyre që kanë kërkuar shërbimin.

Këto përgjigje janë paraqitur në grafikonin e mëposhtëm numër 8.

Grafiku 8 Në cilat situata do të thoshit se personat në një pozicion pushteti më së shpeshti kërkojnë shërbime seksuale në këmbim të sigurimit të një shërbimi publik për të cilin janë kompetent (në raste kur një qytetar do t'i drejtohej një punonjësi të administratës publike, e ai zhvat shërbime seksuale në këmbim të një shërbimi të cilin e ka për detyrë ta sigurojë?)




Tabela Nr. 10.

Në cilat situata do të thoshit se personat në një pozicion pushteti më së shpeshti kërkojnë shërbime seksuale në këmbim të sigurimit të një shërbimi publik për të cilin janë kompetent (në raste kur një qytetar do t'i drejtohej një punonjësi të administratës publike, e ai zhvat shërbime seksuale në këmbim të një shërbimi të cilin e ka për detyrë ta sigurojë?)	Gjinia	
	Meshkuj	Femra
Për të përshpejtuar një punë e cila u nevojitet personave që kërkojnë shërbimin	40,6 %	38,8 %
Për t'iu shmangur një dënimi/problemi	52,4 %	52,1 %
Për të siguruar trajtim/shërbim më të mirë	43,1 %	44,9 %
Për punësim	62,7 %	63,2 %
Tjetër	3,1 %	3,4 %
Refuzon të përgjigjet	3,9 %	2,5 %
Nuk e di	6,2 %	5,6 %

Përgjigjet e të anketuarve, parë nga prizmi i përkatësisë etnike, tregojnë një shpërndarje interesante. Konkretisht, maqedonasit etnikë zakonisht deklarohen se personat që janë në pozitë pushteti, më shpesh kërkojnë shërbime seksuale në këmbim të punësimit (73%), ndërsa shqiptarët etnikë zakonisht thonë se personat në pozitë pushteti më shpesh kërkojnë shërbime seksuale në raste kur kërkuarve të shërbimit duan t'i shmangen një dënimi/problemi (69 %).

Tabela Nr. 11.

Në cilat situata do të thoshit se personat në një pozicion pushteti më së shpeshti kërkojnë shërbime seksuale në këmbim të sigurimit të një shërbimi publik për të cilin janë kompetent (në raste kur një qytetar do t'i drejtohej një punonjësi të administratës publike, e ai zhvat shërbime seksuale në këmbim të një shërbimi të cilin e ka për detyrë ta sigurojë?)	Përkatësia etnike		
	Maqedonas	Shqiptarë	Bashkësi më të vogla etnike
Për të përshpejtuar një punë e cila u nevojitet personave që kërkojnë shërbimin	39,3 %	40,5 %	39,5 %
Për t'iu shmangur një dënimi/problemi	48,4 %	68,9 %	26,3 %
Për të siguruar trajtim/shërbim më të mirë	43,5 %	46,8 %	39,5 %
Për punësim	73,1 %	29,5 %	78,9 %
Tjetër	3,8 %	2,1 %	
Refuzon të përgjigjet	3,1 %	2,6 %	5,3 %
Nuk e di	6,6 %	4,2 %	2,6 %

6. Zhvatja e shërbimeve seksuale brenda vetë institucioneve publike (punonjës nga pozita autoriteti dhe pushteti, ndaj punonjësve tjerë)


Më shumë se gjysma e të anketuarve, punonjës të administratës publike (54%), pajtohen se zhvatja e shërbimeve seksuale nga punonjësit e administratës publike nga një pozicion autoriteti dhe pushteti ndaj punonjësve tjerë brenda vetë institucionit, paraqet një formë korrupsioni.

23% e të anketuarve të punësuar në administratën publike kanë një qëndrim neutral në lidhje me identifikimin e zhvatjes së shërbimeve seksuale si formë korrupsioni.

Shqetësues është fakti që pothuajse 25% e të anketuarve nuk e njohin zhvatjen e shërbimeve seksuale si formë korrupsioni, e të cilët kanë shënuar notën vlerësuese 1 dhe 2, si reflektim i mospajtimit të tyre me deklaratën e ofruar.

Grafiku numër 9 i paraqitur më poshtë tregon shpërndarjen e përgjigjeve në një shkallë nga 1 në 5, ku 5 përfaqëson shkallën më të lartë të pajtimit me deklaratën, ndërsa 1 përfaqëson mospajtim me deklaratën në tërësi.

Grafiku 9 Në një shkallë nga 1 në 5, ku 1 do të thotë nuk pajtohem aspak dhe 5 do të thotë pajtohem plotësisht, sa jeni dakord me deklaratën: **Zhvatja e shërbimeve seksuale nga punonjësit e administratës publike nga një pozicion autoriteti dhe pushteti ndaj punonjësve tjerë brenda vetë institucionit paraqet një formë korrupsioni** (kur një person në një pozicion vendimmarrës ose me autoritet, zhvat shërbim seksual nga një person tjetër, i punësuar në të njëjtin institucion)?



Gjithashtu, duke i parë përgjigjet e të anketuarve nga prizmi i përkatësisë së tyre etnike, vihet re se të anketuarit – pjesëtarë të komunitetit etnik shqiptar, pesë herë më pak se të anketuarit maqedonas etnik, se zhvatja e shërbimeve seksuale nga punonjësit e administratës publike paraqet një formë korrupsioni.


Tabela Nr. 12.

		Përkatësia etnike			Gjithsej
		Maqedonas	Shqiptarë	Bashkësi më të vogla etnike	
Zhvatja e shërbimeve seksuale nga punonjësit e administratës publike nga një pozicion autoriteti dhe pushteti ndaj punonjësve tjerë brenda vetë institucionit, paraqet një formë korrupsioni.	Aspak nuk pajtohem	12,2 %	4,7 %	15,8 %	10,6 %
	2 2	8,9 %	24,7 %	7,9 %	12,6 %
	3 3	19,5 %	35,8 %	21,1 %	23,5 %
	4 4	13,4 %	25,8 %	18,4 %	16,6 %
	Pajtohem plotësisht	45,9 %	8,9 %	36,8 %	36,7 %
Gjithsej:		100,0 %	100,0 %	100,0 %	100,0 %

Dukuria e zhvatjes së shërbimeve seksuale nga punonjës të administratës publike nga pozicion autoriteti dhe pushteti ndaj punonjësve tjerë brenda vetë institucionit, sipas përgjigjeve të të anketuarve nuk është një dukuri e shpeshtë në vendin tonë. Gjegjesisht, një nga dhjetë të anketuar kanë theksuar se kjo nuk ndodh fare në vendin tonë, ndërsa shtatë nga dhjetë të anketuar kanë theksuar se është një fenomen i izoluar që ndodh ndonjëherë (35%) ose rrallë (35%) në vendin tonë.

Frekuenca e fenomenit të zhvatjes së shërbimeve seksuale nga punonjës të administratës publike vërehet nga 17% e të anketuarve, por për 3% prej tyre ose për gjithsej 26 të anketuar, ky fenomen është aktual dhe ndodh vazhdimisht në vendin tonë.

Grafiku 10 Në disa raste, mund të ndodhë që persona të punësuar në administratën publike nga pozicione autoriteti dhe pushteti, të kërkojnë shërbime seksuale nga punonjës tjerë brenda vetë institucionit. Sa shpesh mendoni se ndodh kjo në vendin tonë?



Numri më i madh i përgjigjeve të kryqëzuara të të anketuarve në lidhje me përvojën e tyre personale me zhvatjen e shërbimeve seksuale dhe mendimin e tyre se sa në përgjithësi ndodh ky fenomen në vendin tonë, na tregojnë se ata të anketuar që janë përgjigjur se kanë përjetuar një përvojë personale me zhvatjen e shërbimeve seksuale, por dhe njohin dikë që ka kaluar të njëjtën gjë, kanë përshtypjen se ky fenomen në vendin tonë ndodh vazhdimisht.

Nga ana tjetër, shumica e atyre që nuk kanë përvojë personale, por njohin dikë me një përvojë të tillë, thonë se ky fenomen në vendin tonë ndodh vazhdimisht dhe shpesh.

Madje edhe ata të anketuar që nuk kanë përvojë personale dhe nuk njohin dikë me përvojë të tillë, më së shpeshti përgjigjen se kjo dukuri nuk ndodh asnjëherë ose ndodh rrallë.

7. Përvojat personale

Pyetja e radhës, e cila lidhet me zhvatjen e shërbimeve seksuale nga një person në pozitë pushteti në administratën publike, nxjerr në pah përvojën e të anketuarve, pavarësisht nëse është një përvojë personale apo të anketuarit njohin dikë që ka pasur një përvojë të tillë.

Vihet re se pothuajse dy të tretat (65%) e të anketuarve nuk zbulojnë as përvojën personale, e as të një personi tjetër në lidhje me këtë formë korrupsioni, por kuptohet që duhet pasur parasysh se kur dikush flet për përvojë zhvatjeje të shërbimeve seksuale, ekziston mundësia që ky person të etiketohet dhe diskualifikohet moralisht nga shoqëria, e prandaj edhe nuk denoncohet.


Rreth 24% e të anketuarve kanë theksuar se nuk kanë pasur përvojë personale, por njihnin dikë që ka përjetuar këtë formë korrupsioni, ndërsa 3% e të anketuarve kanë përjetuar personalisht zhvatje për shërbime seksuale. Nga këta 3% ose 22 të anketuar, shtatë janë meshkuj dhe 15 janë femra. Sa i përket përkatësisë etnike, 5 të anketuar janë maqedonas etnik dhe 17 janë pjesëtarë të komunitetit etnik shqiptar.

Është interesante se hulumtimi për aspektet gjinore të korrupsionit i kryer në vitin 2021, në një ekzemplar hulumtimi prej 1000 femrave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, jep një shpërndarje të ngjashme të përgjigjeve. Vërehet një diferencë prej rreth 2% në raport me përgjigjet e të anketuarve për të gjitha përgjigjet e ofruara në hulumtimin e këtij viti.

Tabela Nr. 13.

	Hulumtimi nga viti 2021	Hulumtimi nga viti 2022
Nuk kam përvojë personale, e as njoh dikë	63	65
Nuk kam përvojë personale, por njoh dikë	25,8	24
Mua personalisht dhe një personi që njoh	5,4	3

Grafiku 11 A keni pasur ju personalisht ose një person që ju njihni përvojë me një të punësuar në pozicion autoriteti dhe pushteti (shëf, udhëheqës, drejtor...) që ka kërkuar shërbime seksuale nga punonjës në pozicion më të ulët pune?



Përgjigjet për të njëjtën pyetje, parë nga prizmi i pozicionit të punës së të anketuarve, tregojnë se të anketuarit që janë në pozita drejtuese, deklarohen në një masë më të madhe se kanë pasur një përvojë personale dhe se njohin dikë që ka përjetuar zhvatje seksuale, për dallim nga të anketuarit e punësuar në administratën publike që nuk janë në pozicione drejtuese. Pavarësisht se këto të dhëna për persona në pozicione drejtuese që kanë pasur përvojë personale me zhvatje për shërbime seksuale janë interesante, duhet pasur parasysh se të tillë janë 7.5% apo 6 të anketuar.

Tabela Nr. 14.


		A jeni në pozicion drejtues?		Gjithsej
		Po	Jo	
A keni pasur ju personalisht ose një person që ju njihni përvojë me një të punësuar në pozicion autoriteti dhe pushteti (shef, udhëheqës, drejtor...) që ka kërkuar shërbime seksuale nga punonjës në pozicione më të ulëta pune?	Mua personalisht dhe një personi që njoh	7,5 %	2,2 %	2,7 %
	Nuk kam përvojë personale, por njoh dikë	28,8 %	23,0 %	23,6 %
	As përvojë personale, e as njoh dikë	62,5 %	65,5 %	65,2 %
	Refuzon të përgjigjet	1,3 %	9,3 %	8,5 %
Gjithsej:		100,0 %	100,0 %	100,0 %

Nga të anketuarit (gjithsej 27% ose 211 të anketuar) të cilët janë përgjigjur se një person nga një pozitë autoriteti dhe pushteti (shef, udhëheqës, drejtor...) ka insistuar për shërbime seksuale (prej tyre personalisht ose nga të njohurit e tyre), u kërkua që t'i tregojnë situatat se si ka ndodhur kjo.

Situatat më të zakonshme në të cilat njerëzit në një pozicion autoriteti dhe pushteti (shef, udhëheqës, drejtor...) kërkojnë shërbime seksuale nga punonjësit në pozita më të ulëta, janë paraqitur në grafikun e mëposhtëm numër 12. Katër nga dhjetë të anketuar besojnë se arsytet më të shpeshta janë për të ruajtur vendin e punës (41%) dhe 36% besojnë se kjo më së shpeshti ndodh për qëllime avancimi në punë.

Rreth 13% e të anketuarve kanë refuzuar të tregojnë se në çfarë rrethanash ka ndodhur zhvatja e shërbimeve seksuale.

Grafiku 12 Në këmbim të çfarë shërbimi ju kanë shantazhuar për shërbime seksuale?




Nuk vërehen dallime të veçanta në përgjigjet e të anketuarve, parë nga këndvështrimi i gjinisë së të anketuarit.

Tabela Nr. 15.

Numri i përgjigjeve		Gjinia		Gjithsej
		Meshkuj	Femra	
Në këmbim të çfarë shërbimi ju kanë shantazhuar për shërbime seksuale?	Për t'u avancuar në punë	40	37	77
	Për të ruajtur vendin e punës	40	47	87
	Tjetër	9	11	20
	Refuzon të përgjigjet	11	16	27
Gjithsej		100	111	211


Grafiku i mëposhtëm paraqet përgjigjet e 22 të anketuarve të cilët kanë pasur përvojë personale me zhvatje të shërbimeve seksuale, e që kanë lidhshmëri me veprimet e tyre të mëtejshme. Prej tyre, 82% nuk kanë denoncuar (18 të anketuar), ndërsa 9% (2 të anketuar) kanë denoncuar zhvatjen. Dy të anketuar ose 9% kanë refuzuar t'i përgjigjen kësaj pyetjeje.

Grafiku 13 A keni bërë denoncim kur një person nga një pozicion autoriteti dhe pushteti (shef, udhëheqës, drejtor...) ju ka kërkuar shërbime seksuale si formë korrupsioni (baza, 22 të anketuar)?




Nga gjithsej 27% ose 211 të anketuar që njohin dikë që është përballur me zhvatje të shërbimeve seksuale, vetëm 7% e tyre (14 të anketuar) kanë informacion se viktimat ka denoncuar rastin.

Grafiku 14 A ka denoncuar ajo (personi që njihni) zhvatjen për shërbime seksuale?



Tendenca për të raportuar zhvatjen e shërbimeve seksuale, e cila vërehet nga përgjigjet e të anketuarve, shënon rritje të dukshme kur ata u pyetë në mënyrë hipotetike: A do ta denonconin rastin nëse në të ardhmen do t'u ndodhte diçka e tillë? Kësaj pyetjeje iu përgjigjën vetëm të anketuarit të cilët më parë nuk kanë denoncuar ndonjë përvojë të mëparshme me zhvatje shërbimeshe seksuale. Nga gjithsej 711 të anketuar (89% e numrit të përgjithshëm të të anketuarve), 63% do të merrnin guximin të denoncojnë rastin, ndërsa 17% e të anketuarve do ta mbanin atë në vete. Mund të konkludohet se një përqindje e madhe e popullsisë është e gatshme të denoncojë zhvatjen e shërbimeve seksuale nëse ka pasur një përvojë të tillë. Një nga dhjetë të anketuar beson se nuk ka ku të denoncohen këto lloj shkeljeje, ndërsa 11% e të anketuarve shprehën pamundësinë për të imagjinuar një situatë hipotetike zhvatjeje për shërbimet seksuale që pastaj do ta kishin denoncuar.

Grafiku 15 A do ta kishit denoncuar rastin nëse diçka e ngjashme do t'ju kishte ndodhur juve personalisht?




Nga 448 të anketuarit që do të denonconin nëse do të kishin përjetuar zhvatje për shërbime seksuale në të ardhmen, 24% (106 të anketuar) do ta denonconin rastin në të njëjtin institucion ku ka ndodhur, ndërsa shumica e të anketuarve (76% ose 342 të anketuar) do ta denonconin rastin në një institucion tjetër përkatës të jashtëm.

Raportimi i mbrojtur i brendshëm ose denoncimi bëhet nga brenda, pra në vetë institucionin ose personin juridik ku kryhet kjo vepër e paligjshme.

Në pajtim me ligjin, personi menaxhues në institucionet e sektorit publik cakton një person të autorizuar për pranimin e denoncimeve të dorëzuara, me qëllim të denoncimit të mbrojtur të brendshëm. Në institucionet ku nuk ka person të autorizuar, denoncimi i mbrojtur i brendshëm i bëhet personit drejtues³.

Personi i autorizuar është i detyruar ta informojë signalizuesin jo më shumë se 15 ditë nga dita e pranimin të denoncimit. Në të njëjtën kohë, personi i autorizuar është i detyruar të mbrojtë të dhënat personale të sinjalizuesit, përkatësisht të dhënat që mund të zbulojnë identitetin e sinjalizuesit, i cili raporton në mënyrë anonime ose konfidenciale, konform rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale⁴.

Grafiku 16 Nëse do të kishit denoncuar zhatje për shërbime seksuale, ku do ta kishit bërë këtë?




³ Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve, neni 4.

⁴ Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve, neni 4, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 196/2015, 35/18


Një e treta nga gjithsej 106 të anketuar, të cilët do të kishin denoncuar zhatjen seksuale në vetë institucionin ku u ka ndodhur rasti, do të kishin bërë këtë te drejtori. Rreth 40% e të anketuarve do ta denonconin rastin tek eprorët e tyre dhe 8% do ta ndanin rastin vetëm me kolegët. Vetëm 5% e të anketuarve do t'i drejtoheshin Departamentit për denoncim të mbrojtur të brendshëm.

Grafiku 17 Te cili person do ta kishit denoncuar rastin brenda institucionit ku ju ka ndodhur?




Sa i përket të anketuarve që kanë deklaruar se zhatjen seksuale do ta kishin denoncuar në një institucion të jashtëm, më së shpeshti nga këto institucione përmendet policia (65%). Nga gjithsej 342 të anketuar, rreth dy të tretat e kanë përmendur policinë si institucion ku do ta kishin denoncuar rastin (65%), 20% do t'i ishin drejtuar KSHPK, 10% do ta bënë këtë tek Avokati i Popullit, ndërsa 4% e të anketuarve deklaruan se rasti do t'i paraqitej organizatave qytetare.

Grafiku 18 Në cilin institucion tjetër përkatës të jashtëm do ta kishit denoncuar zhvatjen seksuale?



Si arsye kryesore për mosdenoncimin e zhvatjes së shërbimeve seksuale, të anketuarit shprehën mosbesimin në sistem, stigmatizimin, paragjykimet, etiketimet dhe tabutë. Nga gjithsej 118 të anketuar, 39% shprehin mosbesim në sistem me përgjigjen se denoncimi nuk do të ketë efekt, ndërsa 22% e të anketuarve nuk do ta denonconin rastin për shkak të turpit nga rrethi ku jetojnë. Për 19% të të anketuarve, arsyeja kryesore është frika e paragjykit, ndërsa te 12% do të mbizotëronte frika e largimit nga puna. Rreth 3% e të anketuarve nuk do të denonconin zhvatjen për shërbime seksuale për të shmangur presionin e mëtejshëm në vendin e punës.

Grafiku 19 Pse nuk do ta kishin denoncuar zhvatjen për shërbime seksuale?




8. Denoncimi i mbrojtur

Bazuar në Ligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve, një denoncim i mbrojtur paraqet një parashtrësë që përcjell një dyshim ose njohuri **të arsyeshme** se është kryer, po kryhet ose ka gjasa të kryhet një vepër krimi ose vepër tjetër e paligjshme ose e palejueshme, që dëmton ose kërcënon interesin publik.

Ky ligj rregullon denoncimin e mbrojtur, të drejtat e sinjalizuesve, si dhe veprimet dhe detyrat e institucioneve, përkatësisht të personave juridikë në lidhje me denoncimin e mbrojtur dhe sigurimin e mbrojtjes së sinjalizuesve.

Shqetësues është fakti që madje 71% e të anketuarve të punësuar në administratën publike nuk janë të informuar për mundësinë e denoncimit të mbrojtur në institucionin ku punojnë. Vetëm tre nga dhjetë të anketuar kanë dëgjuar për ekzistimin e një personi të autorizuar për pranimin e parashtrësave për denoncim të mbrojtur të brendshëm.

Grafiku 20 A keni dëgjuar për mundësinë e denoncimit të mbrojtur në institucionin tuaj?




Përkundër faktit se vetëm rreth një e treta e të anketuarve kanë dëgjuar për denoncim të mbrojtur të brendshëm në institucionin ku ndodh rasti, vërehet se te të anketuarit etnik maqedonas kjo përqindje është më e lartë në krahasim me kolegët e tyre nga bashkësitë tjera etnike.

Tabela Nr. 16.

		Përkatësia etnike			Gjithsej
		Maqedonas	Shqiptarë	Bashkësi më të vogla etnike	
A keni dëgjuar për mundësinë e denoncimit të mbrojtur në institucionin tuaj?	Po	31,4 %	24,2 %	21,1 %	29,2 %
	Jo	68,6 %	75,8 %	78,9 %	70,8 %
	Gjithsej:	100,0 %	100,0 %	100,0 %	100,0 %

Mendimet e të anketuarve në lidhje me gjininë e preferuar të personit të caktuar ku mund të denoncohet korrupsioni, janë mjaft të ndara. Më shumë se gjysma e të anketuarve (55%) deklarojnë se nuk do të kishin problem nëse personi i emëruar do të ishte mashkull, por 45% e të anketuarve do të preferonin t'ia raportonin korrupsionin një gruaje.

Grafiku 21 A mendoni se do të ishte më mirë nëse personi i emëruar ku mund të denoncohet korrupsioni është një grua?



Përgjigjet e të anketuarve, parë nga këndvështrimi i të dhënave demografike, tregojnë se shumica (80%) e meshkujve të anketuar janë përgjigjur se nuk ka rëndësi nëse personi ku mund të denoncohet korrupsioni do të ishte një grua. Nga ana tjetër, dy të tretat e të anketuarave – gra të punësuar në administratë publike, janë përgjigjur se do të ishte më mirë nëse personi ku do të mund të denoncohet korrupsioni të ishte një grua.

Tabela Nr. 17.

		Gjinia		Gjithsej
		Meshkuj	Femra	
A mendoni se do të ishte më mirë nëse personi i emëruar ku mund të denoncohet korrupsioni është një grua?	Po	22,7 %	62,8 %	44,9 %
	Jo	77,3 %	37,2 %	55,1 %
	Gjithsej:	100,0 %	100,0 %	100,0 %

Sa i përket përkatësisë etnike, vërehet se për të anketuarit që i përkasin komunitetit etnik shqiptar, për 6% më shumë se të anketuarit maqedonas etnikë, është më e rëndësishme që personi i caktuar ku mund të denoncohet korrupsioni të jetë grua.


Tabela Nr. 18.

		Përkatësia etnike			Gjithsej
		Maqedonas	Shqiptarë	Bashkësi më të vogla etnike	
A mendoni se do të ishte më mire nëse personi i emëruar ku mund të denoncohet korrupsioni është një grua?	Po	44,0 %	50,0 %	34,2 %	44,9 %
	Jo	56,0 %	50,0 %	65,8 %	55,1 %
	Gjithsej:	100,0 %	100,0 %	100,0 %	100,0 %

9. Çrrënjësja e korrupsionit

Për sa i përket pyetjes: A është e mundur të çrrënjëset korrupsioni në administratën publike, përgjigjet tregojnë se të anketuarit kanë shpresë në mundësinë e përballjes me korrupsionin. Më shumë se një e treta e të anketuarve (37%) besojnë se korrupsioni mund të çrrënjëset plotësisht ose të zvogëlohet ndjeshëm, ndërsa 39% besojnë se mund të zvogëlohet deri në një masë të caktuar. Megjithatë, pothuajse një e pesta e të anketuarve të punësuar në administratën publike (21%) nuk besojnë se korrupsioni në administratën publike mund të zvogëlohet aspak.

Grafiku 22 A është e mundur çrrënjësja e korrupsionit në administratën publike?




Nga përgjigjet e të anketuarve lidhur me çrrënjosjen e korrupsionit në administratën publike, parë nga prizmi i përkatësisë etnike të të anketuarve, vërehet se pjesëtarët e komunitetit etnik shqiptar shprehin më shumë optimizëm se korrupsioni mund të zvogëlohet ndjeshëm.

Tabela Nr. 18.

		Përkatësia etnike			Gjithsej
		Maqedonas	Shqiptarë	Bashkësi më të vogla etnike	
A mund të çrrënjohet korrupsioni në administratën publike?	Korrupsioni nuk mund të zvogëlohet aspak	22,5 %	12,6 %	36,8 %	20,8 %
	Korrupsioni mund të zvogëlohet deri në një shkallë të caktuar	39,8 %	38,9 %	23,7 %	38,8 %
	Korrupsioni mund të zvogëlohet ndjeshëm	27,9 %	38,9 %	23,7 %	30,3 %
	Korrupsioni mund të çrrënjohet plotësisht	6,8 %	7,9 %	13,2 %	7,4 %
	Nuk e din	3,0 %	1,6 %	2,6 %	2,6 %
Gjithsej:		100,0 %	100,0 %	100,0 %	100,0 %

Të anketuarit që shprehën optimizëm se korrupsioni mund të zvogëlohet ose çrrënjohet, u pyetën më tej për mënyrat se si mund kjo të bëhet. Pyetja ofronte mundësinë e përgjigjeve të shumta dhe të anketuarit kryesisht përmendën ligjet më të rrepta (78%) dhe ndjekjen penale (70%), si mënyrat më të përshtatshme për të luftuar korrupsionin dhe zvogëlimin e tij brenda administratës publike. Për më tepër, si mënyra efektive për zvogëlimin e korrupsionit, të anketuarit kanë radhitur siç vijon: inkurajimin e zbulimit të rasteve që lidhen me korrupsionin (47%), rritjen e shkallës së transparencës (37%), fushatën publike (26%) dhe stigmatizimin publik (25%).


Grafiku 23 Në çfarë mënyre mendoni se mundet të zvogëlohet apo çrrënjohet korrupsioni në administratën publike? (pyetje me mundësi për më shumë zgjedhje, shuma e përqindjeve mund të kalojë 100 %)



Të anketuarit të cilët më parë shprehnin pesimizëm se korrupsioni nuk mund të zvogëlohet apo çrrënjohet (21% ose 167 të anketuar), u pyetën më tej për arsyet e këtij qëndrim.

Pyetja kishte mundësinë e përgjigjeve të shumëfishta dhe të anketuarit arsyet e luftës së pasuksesshme për zvogëlimin e korrupsionit lryesisht i shohin në përhapjen e madhe të korrupsionit dhe faktin se korrupsioni tashmë është bërë pjesë e mentalitetit të njerëzve (63%). Gjithashtu, më shumë se 60% e përgjigjeve shkakun e shohin edhe në moszbatimin e ligjeve dhe mosndëshkimin e shkelësve. Sipas të anketuarve, është e nevojshme të zbardhen rastet e proceduara, të cilat do të tregojnë se sistemi lufton, ballafaqohet dhe zbaton plotësisht procedurat që kanë të bëjnë me korrupsionin.

Grafiku 24 Pse mendoni se korrupsioni në administratën publike nuk mund të zvogëlohet?



GJETJET KRYESORE

Korrupsioni si problem

- ◆ Pothuajse një e katërta, gjegjësisht 23% e të anketuarve kanë theksuar se korrupsioni paraqet një **problem të madh**, 39% kanë theksuar se është problem i vogël, ndërsa për një të tretën e të anketuarve korrupsioni nuk paraqet aspak problem në vendin e tyre të punës në administratën publike.

Nxitja dhe nënshtrimi ndaj korrupsionit

- ◆ Rreth dy të tretat e të anketuarve (68%) kanë theksuar se **nuk i dallojnë aspektet gjinore të korrupsionit**, gjegjësisht si meshkujt ashtu edhe femrat i nënshtrohen korrupsionit në mënyrë të njëjtë. Rreth 15% e të anketuarve besojnë se femrat janë më pak të prekura nga korrupsioni sesa meshkujt, mirëpo nga ana tjetër pothuajse një nga dhjetë të anketuar mendon krejtësisht të kundërtën – se femrat i nënshtrohen korrupsionit më shumë se meshkujt.
- ◆ Më shumë se gjysma (55%) e të anketuarve besojnë se femrat e punësuar në administratën publike janë **po aq të korruptuara** kur ato janë në pozita më të larta të pushtetit ose pozita drejtuese. Rreth 29% e të anketuarve mendojnë se femrat janë më pak të korruptuara kur janë në pozita më të larta, por një nga dhjetë të anketuar mendojnë se ato janë, megjithatë, më të korruptuara kur janë në pozita më të larta pushteti apo pozita drejtuese.

Zhvatja e shërbimeve seksuale nga punonjësit e administratës shtetërore ndaj qytetarëve si përdorues të shërbimeve

- ◆ Zhvatja e shërbimeve seksuale nga punonjësit e administratës publike në këmbim të dhënies së një shërbimi **njihet si një formë korrupsioni nga rreth 61% e të anketuarve**, të punësuar në administratën publike (42% janë pajtuar plotësisht me këtë deklaratë, ndërsa 19% pajtohen deri në një masë të caktuar).
- ◆ 11% e të anketuarve mendojnë se zhvatja e shërbimeve seksuale për të siguruar një shërbim në administratën publike nuk paraqet formë korrupsioni, ndërsa 8% e të anketuarve shprehin dyshim të vogël. Një e pesta (21%) e të anketuarve të punësuar në administratën publike, kanë qëndrim neutral.
- ◆ Duhet gjetur mekanizma për të nxitur diskutimin, për të monitoruar situatat dhe për të informuar publikun për temat që lidhen me zhvatjen e shërbimeve seksuale si një formë korrupsioni.

Njohuritë për format specifike të korrupsionit

- ◆ Më shumë se 60% e të anketuarve janë përgjigjur se zhvatja e shërbimeve seksuale si një formë specifike korrupsioni, nuk njihet dhe dallohet mjaftueshëm në opinionin publik – në diskutime, politika dhe rregullore ligjore në vendin tonë (të dhëna të përmbledhura, “pak” ose “aspak” nuk dihet për këtë temë).
- ◆ 11% e të anketuarve mendojnë se zhvatja seksuale si formë e korrupsionit nuk njihet në vendin tonë aspak.

- ◆ Më shumë se një e treta e të anketuarve të punësuar në sektorin publik besojnë se zhvatja seksuale si një formë korrupsioni njihet dhe dallohet mjaftueshëm nga opinion publik.
- ◆ Mundësia që njerëzit në pozicione të kërkojnë favore seksuale, në vend të formave tjera të korrupsionit (para/ryshfet), konsiderohet nga të anketuarit se ndodh ndonjëherë (37%).
- ◆ Rreth një e treta ose 34% e të anketuarve janë shprehur se këto janë situata të rralla, ndërsa 13% dyshojnë plotësisht në mundësinë që njerëzit nga pozicion pushteti të kërkojnë favore seksuale, në vend të formave tjera të korrupsionit (para/ryshfet).
- ◆ 14% e të anketuarve theksojnë se kjo dukuri është e shpeshtë dhe 1% e të anketuarve besojnë se është një praktikë e vazhdueshme që personat në pozitë pushteti të kërkojnë favore seksuale në vend të formave tjera të korrupsionit.

Prania e zhvatjes seksuale në institucione

- ◆ **Shëndetësia** është fusha ku të anketuarit e punësuar në administratën publike besojnë se zhvatja seksuale si formë korrupsioni ndodh më shpesh. Përgjigjet e përmbledhura për “vazhdimisht” dhe “shpesh” përbëjnë 23% të të anketuarve që vërejnë shpërdorim të detyrës publike ose kompetencave me qëllim të përfitimit të shërbimeve seksuale (në raste kur një qytetar që ka ardhur te një punonjës në administratën shtetërore, e ky i fundit zhvat shërbime seksuale në këmbim të një shërbimi të cilin e ka për detyrë ta sigurojë).
- ◆ Rreth një e treta e të anketuarve besojnë se situatat më të shpeshta në të cilat personat në pozitë pushtetit kërkojnë shërbime seksuale në këmbim të dhënies së një shërbimi publik për të cilin ata janë përgjegjës ndodhin për arsye **punësimi** (30%) dhe **shmangie të një dënimi** ose një problemi me të cilin përballen ata që kërkojnë shërbimin (25%).

- ◆ Një e pesta e të anketuarve besojnë se njerëzit në një pozicion pushteti më së shpeshti kërkojnë shërbime seksuale në këmbim të **sigurimit të një trajtimi më të mirë** (21%) dhe për të **përsheptuar një punë ose procedurë** që u nevojitet personave që kërkojnë shërbimin e caktuar.

Zhvatja e shërbimeve seksuale brenda vetë institucioneve publike (punonjës nga pozita autoriteti dhe pushteti, ndaj punonjësve tjerë)

- ◆ Më shumë se gjysma (54%) e të anketuarve, punonjës të administratës publike, pajtohen se zhvatja e shërbimeve seksuale nga punonjësit e administratës publike nga pozita e autoritetit dhe pushtetit ndaj punonjësve tjerë brenda vetë institucionit, paraqet një formë korrupsioni.
- ◆ Te 23% e të anketuarve të punësuar në administratën publike vërehet një qëndrim neutral në lidhje me njohjen e zhvatjes së shërbimeve seksuale si formë korrupsioni.
- ◆ Një nga dhjetë të anketuar kanë theksuar se zhvatja për shërbime seksuale nuk ndodh aspak në vendin tonë, ndërsa shtatë nga dhjetë të anketuar kanë theksuar se është një fenomen i izoluar që në vendin tonë ndodh ndonjëherë (35 %) ose rrallë (35 %).
- ◆ Frekuenca e fenomenit të zhvatjes së shërbimeve seksuale nga punonjësit e administratës publike e dallojnë 17% e të anketuarve, por 3% e të anketuarve kanë theksuar se ky fenomen është aktual dhe ndodh gjatë gjithë kohës në vendin tonë.

Përvojat personale

- ◆ Pothuajse dy të tretat (65 %) e të anketuarve nuk kanë përvojë personale e nuk kanë njohuri për përvoja të tilla të një personi tjetër në lidhje me zhvatjen seksuale si një formë korrupsioni.
- ◆ Rreth 24% e të anketuarve janë shprehur se nuk kanë pasur përvojë personale, por njohin dikë që ka përjetuar këtë formë korrupsioni dhe 3% e të anketuarve që personalisht kanë përjetuar dhe janë ballafaquar me pasojat e zhvatjes për shërbime seksuale. Nga këta 3% të anketuar, 33% janë meshkuj dhe 67% janë femra.
- ◆ Katër nga dhjetë të anketuar besojnë se situatat më të shpeshta në të cilat një person nga një pozicion autoriteti dhe pushteti (shëf, udhëheqës, drejtor...) kërkon shërbime seksuale nga punonjësit në pozita më të ulëta, janë për të ruajtur vendin e punës (41%), ndërsa 36% besojnë se kjo zakonisht ndodh për avancim në punë.
- ◆ Nga 22 të anketuar që kishin përvojë personale me zhvatje për shërbime seksuale, 82% nuk e kanë denoncuar atë, ndërsa 9% e të anketuarve kanë denoncuar këtë zhvatje. Dy të anketuar ose 9% kanë refuzuar t'i përgjigjen kësaj pyetjeje.
- ◆ Nga gjithsej 27% ose 211 të anketuar që njohin dikë që është përballur me zhvatje shërbimesh seksuale, vetëm 7% e tyre janë në dijeni se viktima ka denoncuar veprën.
- ◆ Nëse zhvatja për shërbime seksuale do t'u ndodhte atyre në të ardhmen, 63% e të anketuarve do ta denonconin rastin, ndërsa 17% e të anketuarve do ta mbanin atë në vete.
- ◆ Një nga dhjetë të anketuar beson se nuk ka ku të denoncojë këtë lloj shkeljeje, ndërsa 11% e të anketuarve shprehën pamundësinë për të imagjinuar një situatë hipotetike të zhvatjes së shërbimeve seksuale, e të cilin rast do ta denonconin.

- ◆ Nga 448 të anketuar që do të denonconin nëse në të ardhmen do të kishin përjetuar zhvatje për shërbime seksuale, 24% do ta bënin këtë në të njëjtin institucion ku ka ndodhur, ndërsa shumica e të anketuarve (76%) do ta denonconin rastin në një institucion tjetër të jashtëm përkatës.
- ◆ Një e treta e gjithsej 106 të anketuarve që do të kishin denoncuar zhvatjen seksuale në vetë institucionin ku ka ndodhur, do të bënin këtë te drejtori. Rreth 40% e të anketuarve do ta denonconin rastin tek eprorët e tyre dhe 8% do ta ndanin këtë vetëm me kolegët e tyre. Vetëm 5% e të anketuarve do t'i drejtoheshin Departamentit për denoncimin e mbrojtur të brendshëm.
- ◆ Të anketuarit që janë shprehur se do të kishin denoncuar zhvatjen seksuale në një institucion të jashtëm, më së shpeshti do ta bënin këtë në polici (65%), 20% e të anketuarve do t'i drejtoheshin Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, 10% do ta lajmëronin rastin te Avokati i Popullit, ndërsa 4% e të anketuarve janë shprehur se do ta kishin denoncuar rastin te organizatat e shoqërisë civile.
- ◆ Nga gjithsej 118 të anketuar, 39% ose 46 prej tyre shprehin mosbesim ndaj sistemit me përgjigjen se denoncimi nuk do të ketë efekt, ndërsa 22% ose 26 të anketuar nuk do të denonconin për shkak të turpimit nga mjedisi. Për 19% ose 23 të anketuar, arsyeja kryesore është frika nga paragjykimi, ndërsa, nga ana tjetër, te 12% ose 14 të anketuarve do të mbizotëronte frika e largimit nga puna. Rreth 3% ose 4 të anketuar nuk do të denonconin zhvatje për shërbime seksuale për të shmangur presionin e mëtejshëm në vendin e punës.

Denoncimi i mbrojtur

- ◆ 71% e të anketuarve të punësuar në administratën publike nuk janë të informuar për mundësinë e denoncimit të mbrojtur në institucionin ku punojnë. Vetëm tre nga dhjetë të anketuar kanë dëgjuar për ekzistencën e një shërbimi të tillë.

- ◆ Më shumë se gjysma e të anketuarve (55%) deklarojnë se nuk do të kishin problem nëse personi i emëruar do të ishte burrë, por 45% e të anketuarve do të preferonin t'ia raportojnë korrupsionin një gruaje.
- ◆ Duhet të ndërmerren përpjekje shtesë për të informuar punonjësit për ekzistencën dhe mundësitë që ofron mekanizmi për denoncimin e mbrojtur të brendshëm.

Çrrënjësja e korrupsionit

- ◆ Më shumë se një e treta e të anketuarve (37%) besojnë se korrupsioni mund të çrrënjëset plotësisht ose të zvogëlohet deri në një masë të konsiderueshme, ndërsa 39% e të anketuarve besojnë se korrupsioni mund të zvogëlohet deri në një shkallë të caktuar. Megjithatë, thujse një e pesta e anketuarve të punësuar në administratën publike (21%) nuk besojnë se korrupsioni në administratën publike mund të zvogëlohet.
- ◆ Mënyrat me të cilat është e mundur çrrënjësja e korrupsionit janë: ligje më të rrepta (78%), ndjekja penale (70%), inkurajimi i zbulimit të rasteve që lidhen me korrupsionin (47%), rritja e shkallës së transparencës (37%), fushatat publike (26%) dhe stigmatizimi publik (25%).
- ◆ Lufta e pasuksesshme për zvogëlimin e korrupsionit reflektohet në përhapjen e madhe të tij dhe tashmë korrupsioni është bërë pjesë e mentalitetit të njerëzve (63%), si dhe paraqet rezultatin e moszbatimit të ligjeve dhe mosndëshkimit të kundërvajtësve.
- ◆ Të anketuarit i konsiderojnë masat represive më efektive sesa masat parandaluse.



ISBN: 978-92-9271-070-5